- cultivates a critical engagement with media, encouraging them to question and reflect on the cultural messages and ideologies presented in film and television.

Elaboration of the topic

The relationship between movies and culture involves a complicated dynamic; while movies certainly influence the mass culture that consumes them, they are also an integral part of that culture, a product of it, and therefore a reflection of prevailing concerns, attitudes, and beliefs.

Just as movies reflect the anxieties, beliefs, and values of the cultures that produce them, they also help to shape and solidify a culture's beliefs. Sometimes the influence is trivial, as in the case of fashion trends or figures of speech. After the release of *Flashdance* in 1983, for instance, torn T-shirts and leg warmers became hallmarks of the fashion of the 1980s (Pemberton-Sikes, 2006). However, sometimes the impact can be profound, leading to social or political reform, or the shaping of ideologies.

Dealing with this topic in the context of intercultural communication is of special importance for students in many aspects.

The influence of films on culture can be highly beneficial for students in several ways, enriching their education and personal development; films often depict various cultural traditions, values, and social norms, allowing students to gain insights into cultures different from their own. This exposure helps foster empathy, cultural sensitivity, and a broader world understanding of the cultural context of different periods. This aids in grasping the complexities of history and its influence on contemporary society.

Analysing films as cultural texts teaches students to critically examine the underlying messages, symbols, and ideologies presented in media. Films can either reinforce or challenge stereotypes. By analysing these portrayals, students learn to recognize and critique biased representations, contributing to a more nuanced understanding of identity and power dynamics. Discussing and writing about films helps students articulate their thoughts clearly and persuasively, enhancing their communication skills both orally and in writing. Films that challenge conventional narratives or present complex moral dilemmas can stimulate innovative thinking, encouraging students to explore new ideas and solutions in various aspects of life.

Films often integrate elements of literature, history, politics, psychology, and art. Analysing films allows students to make connections across different academic disciplines, promoting a holistic approach to learning. Films often prompt self-reflection, encouraging students to think about their own beliefs, values, and experiences concerning the characters and situations they see on screen.

Films have the potential to influence the cultural norms that exist in a community. And the way these trends shape the new generation. A wide constellation of films has traditionally portrayed violence, The Godfather Trilogy (1972, 1974, and 1990), Goodfellas (1990), The Departed (2006), and Scarface (1983); The films discuss pressing social issues and injustice, which helps they start dialogues and enable individuals to think about issues from a variety of perspectives, which is a positive outcome. When they draw attention to important issues, films have the power to motivate individuals and communities to take action, which, in turn, can drive positive social change. Also, movies do more than just entertain; they are a powerful cultural force that changes beliefs and principles shared by most people.

Throughout the twentieth century and beyond, Film has served as one of the most influential and accessible mediums of cultural diplomacy and it has had a unique ability to affect "the masses" all around the world. In particular, certain films have succeeded at not only entertaining audiences but have served as examples of films that have truly helped to educate, enhance, and sustain relationships, break stereotypes, and transcend borders at several levels.

Many movies throughout different periods have had a big impact on individuals' culture.

La grande illusion (1937)- It is a film that is best described as 'anti-war' - hardly surprising, given that it was made on the eve of war and that its focus is on the worldwide conflict that preceded it. the film's message is that there is an innate goodness within man that allows us to act with decency and respect with all people *Gone with the Wind*- (1939) represents a monumental leap in cinematic creation educating the audience on American history and identity.

Hiroshima Mon Amour (1956), - demonstrates the importance of international cooperation, showing the dangers of what can happen when sociocultural conflicts are allowed to develop and mutate... *My*

America (1997)- explores the challenges of Asian Americans, as they are no longer 'the invisible minority' *My Big Fat Greek Wedding (2002)*- Brings to the fore the problems that can arise when dealing with differing identities in the contemporary world *The same sun (2012)*- A retrospective glance at the moment when peace was brokered between Israel and Palestine. They overcome the cultural divisions between their families to start their businesses peacefully and efficiently

So, film culture plays an important role in our society, being a key part of our cultural identity, being shaped and constantly being shaped by our world. This inextricable connection between film and society is what makes it so important – and why it will always remain a key part of our cultural landscape.

Again, we have the role of media in increasing the investigative and analytical capacities of students and developing a framework of critical approaches. So, by incorporating research into the process of teaching, we can help students to develop critical skills to become more informed about media and better understand the power of media in shaping perceptions and their beliefs.

Practical activity

Students are asked to analyse films as cultural texts that reflect and shape intercultural communication. They discuss how different cultures are portrayed in international cinema and how these portrayals influence intercultural understanding.

Students can compare and contrast films from different cultures that deal with similar themes (e.g., migration, family, identity) and discuss how cultural context influences the narrative and character development. Students are divided into two groups depending on the films they will choose. Each group will submit an essay after watching and analysing the films that apply to two cultures. Topics can be chosen by the teacher or the students have the right to choose.

References

Understanding Media and Culture: An Introduction to Mass Communication. (2016). University of Minnesota.
Lynn, H. (2023). *The Impact of Film on Culture: Reflections on Movie Industry, Violent Impact and Politicized Content Production.*

Proceedings of the International Conference on Global Politics and
Socio-Humanities DOI: 10.54254/2753-7064/13/20230366

Film as Cultural Diplomacy, Academy for Cultural Diplomacy.

https://www.culturaldiplomacy.org/academy/index.php?en_film-as-cultural-diplomacy

Çela, E., Myzeqari, I., Sotirofski, K., Zguri, Rr. (2023) *Udhëzues për përfshirjen e edukimit për median dhe informacionin në Kurrikulën universitare. Qasja e të mësuarit përmes lëndës specifike dhe integritit ndërlëndor.* Instituti Shqiptar i Medias

Pjesa II

PROJEKSIONE DHE ANALIZA MBI INTEGRIMIN E NJOHURIVE MBI EMI-n NË KURRIKULAT UNIVERSITARE

1. **ALDA CICKO**, Çështje të normës gjuhësore dhe përdorimit të leksikut terminologjik në ligjërimin mediatik
2. **ERINDA RUSTEMI**, Rivlerësimi i studimit të letërsisë në universitet: ndikimi i IA dhe qasjet e studentëve
3. **OLSA PEMA**, Integrimi i hapësirës mediatike të podkastit në programin e historisë dhe qytetërimit amerikan
4. **DORELA KAÇAUNI**, Ndikimi i mediave në shkrimin akademik
5. **LINDITA KAÇANI**, Rëndësia e përfshirjes së edukimit për median dhe informimin në sociolinguistikë
6. **LORENA ROBO**, Ndikimi dhe roli i medias dhe rrjeteve sociale në gjuhë dhe kulturë - ndryshimi gjinor në perceptimin mediatik
7. **EVIONDA PYLLI**, Rëndësia e edukimit për median në nxitjen e zhvillimit të të menduarit kritik.
8. **SUELA KOÇA**, Rëndësia e mësimdhënies së gramatikës e integruar me burime dhe mjete të ndryshme mediatike
9. **EDLIRA XEGA**, Integrimi i edukimit për median në komunikimin ndërkulturor në mësimdhënie

ÇËSHITJE TË NORMËS GJUHËSORE DHE PËRDORIMIT TË LEKSIKUT TERMINOLOGJIK NË LIGJËRIMIN MEDIATIK

Alda Cicko

acicko@unkorce.edu.al

Ligjërimi mediatik si pjesë e komunikimit publik realizohet në një hapësirë të veçantë shoqërore prandaj është mëse e nevojshme që të flitet për veçantitë e tij në raport me ligjërimitet e tjera gjuhësore, jo vetëm nga pikëpamja e rrafshit të përmbajtjes por edhe të rrafshit formalo-strukturor. Në këtë kontakt mund të analizohet shumësia e formave konkrete përmes së cilave realizohet ky ligjërimit (gazeta, radio, televizion, internet) por edhe shtresëzimi i tij sipas funksioneve gjuhësore (zhanret e ndryshme, llojet e ligjërimit etj.).

Dinamizmi i zhvillimit gjuhësor është rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha shoqërore, ekonomike dhe kulturore, në të cilin marrin pjesë në mënyrë intensive edhe mjetet e komunikimit publik. Ky zhvillim shoqërohet me prirje pozitive e përparim të vërejtshëm në rrafshet e pasurimit dhe përsosjes së gjuhës. (Islamaj, 2004, 43)

Media është një institucion i rëndësishëm gjuhësor. Gjuha e përdorur në ligjërimitin mediatik zë vendin kryesor në komunikimin gjuhësor të shoqërisë moderne. Ligjërimiti mediatik pasqyron dhe formëson përdorimitin e gjuhës dhe qëndrimin që mban ndaj saj çdo bashkësi gjuhëfolëse. (Bell, 2008, 5)

Sikundër shprehet edhe Akademik Jani Thomai, “ligjërimiti publicistik është shumë i gjerë në problematikë, i larmishëm në gjini e lloje, dhe, mjaft dinamik në zhvillim dhe i hapur për lëvizje në sistemin e mjeteve të shprehjes” (Thomai, 2017, 412)

Në këtë kontekst, një aspekt i veçantë të analizës së bërë mbi gjuhën e përdorur në ligjërimitin mediatik është edhe qëndrimi i mbajtur ndaj normës gjuhësore dhe në veçanti asaj leksikore. Ligjërimiti i ri dhe ky kontekst i ri në botën e komunikimit global ka sjellë ndryshime të ndjeshme edhe në strukturën e vetë segmentit komunikues, duke

ripërkufizuar në këtë mënyrë botëkuptimin e subjekteve që marrin pjesë në këtë komunikim dhe duke lëkundur kufirin që duhet të ekzistojë midis stilit formal dhe atij informal.

Mjetet e informimit luajnë një rol të rëndësishëm në pasurimin e gjuhës, mbrojtjen dhe ruajtjen e standardit dhe jo në pak raste ndikojnë edhe në shfaqjen e larmisë gjuhësore. Ndër të tjera, ato janë përgjegjëse për kultivimin, zbatimin dhe shtrirjen e gjuhës standarde, si dhe për cilësisë e shprehjes gjuhësore.

Në këtë kuadër është e nevojshme që studentët të njihen me disa prej çështjeve më të rëndësishme të diskutimit të gjerë mbi edukimin mediatic të cilat lidhen kryesisht me respektimin e normës dhe standardit në mjetet e reja të informimit, me shkallën dhe nivelin e respektimit të rregullave gjuhësore dhe stilistikore në ligjërimin mediatic, me prirjen e krijimit të një varianti gjuhësor të përzierë të folmesh të nënstandardit, me shenjuesit e rinj stilistikorë të cilat ligjërimi mediatic i shfrytëzon si mjete dhe strategji marketingu për të arritur sa më shpejt maksimumin e dëgjueshmërisë, shikueshmërisë dhe lexueshmërisë, apo me ndikimin që ushtron gjuha e përdorur në media mbi normën gjuhësore.

Përveç shqyrtimit të pjesës teorike në ligjëratat e hartuara në kuadrin e edukimit mbi median, përmes veprimtarive konkrete dhe materialeve të vëna në dispozicion, studentët do të analizojnë shkallën e respektimit të normës gjuhësore dhe shfrytëzimin në masën e dëshiruar të risimtarisë gjuhësore, hapjes së leksikut, purizmit dhe ekonomizmit gjuhësor sikundër dhe përdorimin e leksikut terminologjik, kalkeve, gjedheve fjalëformuese, pleonazmave dhe figurshmërisë.

Në rrafshin logjik dhe përmbajtësor, studentët do të vlerësojnë shkallën e përmbushjes së saktësisë, qartësisë dhe ngjeshjes kuptimore veçanërisht në radio dhe televizion ndërsa në rrafshin leksikor, përdorimin e fjalëve-terma, ndërkombëtarizmave, neologjizmave, kalkimeve, huazimeve dhe zhargoneve.

Përmes veprimtarive praktike, studentët gjithashtu do të mund të identifikojnë disa prej veçorive kryesore të ligjërimin mediatic, kulturën gjuhësore, ekonomizmin e shprehjes dhe respektimin e standardizimit terminologjik.

Pjesë e rëndësishme e rolit dhe rëndësisë së gjuhës standarde në ligjërimin mediatik është edhe njohja dhe vlerësimi i përdorimit të leksikut terminologjik në këtë fushë.

Benson shprehet se “njohja dhe përvetësimi i termave të medias si pjesë e edukimit mediatik, nuk është thjesht e rëndësishme, por thelbësore” (Benson, 2024, 7)

Tërësia e termave të përdorura në komunikimin mediatik është e gjerë dhe është pasuruar ndjeshëm veçanarisht në dekadat e fundit. Duke qënë se terminologjia e një shkence apo fushe të caktuar është e njësuar, fjalët terma të përdorura në leksikun terminologjik të përdorur në media janë përgjithësisht monosemantikë dhe zakonisht me kuptim të drejtpërdrejtë, pa ngjyime shprehëse-emocionuese, pa frazeologji e pa figura gjuhësore. Terminologjia është fusha më problemore në hapësirën e leksikut, për veçantitë që ka në lidhje me kodifikimin, njësimin dhe përdorimin e gjithmbarshëm. Standardizimi i terminologjisë profesionale të medias po shihet gjithnjë e më shumë si pjesë e kultivimit të kulturës gjuhësore.

Duke qenë se edhe terminologjia e medias si fushë e dijes është në ndryshim të vazhdueshëm, ajo është pasuruar mjaft me studime dhe me fjalorë të shumtë me vlera teorike dhe praktike.

Në shtyp dhe në mediat auto-vizive leksiku është zgjeruar e është përzier në disa drejtime dhe është ngushtuar dhe specializuar në drejtime të tjera duke sjellë shpesh herë përsëritje të shpeshta ose shtampa gjuhësore, kryesisht të huazuara apo të kalkuara. Kjo veçanti ka sjellë edhe nevojën për materializimin e prurjeve të reja leksikore, kryesisht terma të cilat gjithmonë e më shumë po ndërkombëtarizohen.

Njohja e leksikut terminologjik të medias dhe nevoja për përdorimin e fjalorëve apo glosarëve me fjalë-terma të përdorura në ligjërimin mediatik do ti ndihmojë studentët të interpretojnë mënyrën se si fjalorët e terminologjisë së medias shpjegojnë një numër të madh konceptesh duke u nisur nga aspektet teknike të prodhimit mediatik deri tek ndikimi shoqëror dhe kulturor që ushtron media në shoqëri. Gjithashtu në kuadrin e edukimit mbi median ata do të ndërgjegjësohen për faktin se njohja dhe përdorimi i drejtë i termave të medias na ndihmon të kuptojmë mënyrat dhe format komplekse me

të cilat mesazhet e përcuara përmes medias sendërtohen, shpërndahen dhe interpretohen.

Një rëndësi të veçantë në këtë aspekt ka edhe përzgjedhja e materialeve në mënyrë individuale dhe të pavarur mbi të cilat ata do të kryejnë një analizë të detajuar të të gjitha rasteve kur korpusi i leksikut terminologjik i fushës së medias është shfrytëzuar në mënyrë shterruese. Në të njëjtën mënyrë përmes vëzhgimit të situatave ligjërimore të mediave ata do të mund të gjurmojnë dhe analizojnë rastet kur përdorimi i leksikut terminologjik dhe i normës karakteristike për këtë stil ligjërimi është respektuar apo shmatur, lënë jashtë vëmendjes ose shkelur.

Bibliografia

Benson, M. (2024) A deep dive into the literacy of media, Britannica Education

Bell, A. (2008) Language and the media, Cambridge University Press

Ismalaj, Sh. (2004) Gjuha, ligjërimi dhe fjala, Instituti Albanologjik i Prishtinës

Thomai, J. (2017) Fjala dhe leksiku, Instituti i Studimeve Albanologjike

RIVLERËSIMI I STUDIMIT TË LETËRSISË NË UNIVERSITET: NDIKIMI I IA DHE QASJET E STUDENTËVE

Erinda Papa

epapa@unkorce.edu.al

Hyrje

Në epokën e zhvillimit të shpejtë teknologjik, integrimi i inteligjencës artificiale (IA) në arsim ka transformuar ndjeshëm mësimdhënien dhe të nxënët. Ky ndërveprim midis IA-së dhe studimeve letrare ofron një mundësi për të ndryshuar mënyrën se si studentët lexojnë dhe kuptojnë tekstin letrar (Nazari et al., 2021). Në Departamentin e gjuhëve të huaja në Universitetin Fan S. Noli, (UNIKO), lektorët dhe studentët përballen me një peizazh që ndryshon me shpejtësi për shkak të mjeteve dhe platformave të bazuara në IA në mësimdhënien e gjuhëve dhe letërsisë. Në procesin e kalimit në epokën digjitale, mësimdhënësit e letërsisë duhet të marrin parasysh ndikimin e teknologjisë IA mbi proceset e shkrimit dhe leximit krahas rezultateve të të nxënët. Ky studim përpiqet të hedhë dritë mbi mënyrën se si IA ndikon në stilet e shkrimit, në interpretimin e teksteve letrare dhe reagimet e studentëve ndaj mësimdhënies së letërsisë angleze. Qëllimi i këtij studimi modest është të zbulojë aspektet pozitive dhe negative të zbatimit të IA-së në mësimdhënien e letërsisë, për të formuar bazën e diskutimit mbi rolin e teknologjisë në pedagogjinë inovative.

Qëllimi i studimit

Ky studim është thelbësor sepse shqyrton ndikimin e IA-së në shkrimin dhe leximin e teksteve letrare në gjuhën angleze në UNIKO. Me zhvillimet teknologjike në arsim, mësuesit, studiuesit dhe politikëbërësit duhet të kuptojnë plotësisht efektet e IA-së në mësimdhënie. Ky punim do të mbështetet në teknikat pedagogjike të orientuara nga teknologjia dhe në politikat arsimore duke nxjerrë në pah se si integrimi i IA-së ndikon në stilet e shkrimit, në interpretimin e teksteve letrare dhe në reagimet e studentëve. Studimi shqyrton

sfidat dhe përfitimet e teknologjisë IA në mësimdhënien e letërsisë, duke ndihmuar mësimdhënësit për të tërhequr interesin e studentëve dhe për të përmirësuar të menduarit kritik.

Konteksti

Teknologjia IA ka potencialin të revolucionarizojë metodat tradicionale të mësimdhënies dhe të nxënies. Si pasojë, ajo ka tërhequr së fundmi vëmendjen e palëve të interesit në fushën e arsimit (Chen & Yuan, 2022). Inteligjenca artificiale hap mundësinë për ta bërë të kuptuarit e kryeveprave të letërsisë angleze më ndërvepruese dhe më të thelluar. Për të përmbushur nevojat e ndryshme të studentëve dhe stilet e tyre të të nxënit, lektorët mund të ofrojnë përvoja mësimore të personalizuar, feedback pozitiv dhe mjete vlerësimi të automatizuara përmes algoritmeve dhe platformave IA (Fitria, 2021). Studentët mund të analizojnë gjithashtu tekstet më në thellësi duke përdorur mjetet e analizës së tekstit të bazuara në IA, të cilat përmirësojnë shpejtësinë dhe saktësinë, duke zbuluar tema, ide, modele dhe mjete letrare të fshehura.

Po kështu, shfaqja e platformave online të të nxënit dhe digjitalizimi i veprave letrare ka hapur mundësi të reja për zbatimin e teknologjisë IA në trajtimin e tekstit letrar. Sipas Chen et al. (2023), chatbot-et e fuqizuara nga IA, tutorët virtualë dhe teknologjitë e përpunimit të gjuhës mund të ndihmojnë mësimdhënësit të krijojnë një mjedis mësimor më tërheqës dhe ndërveprues, ku studentët marrin pjesë aktive dhe japin feedback pozitiv. Khabib (2022) vëren se, me avancimin e teknologjisë IA dhe rolin e saj gjithnjë e më të spikatur në arsim, mësuesit e letërsisë duhet të shqyrtojnë efektet e IA-së mbi metodat e tyre të mësimdhënies dhe të përshtatin qasjen e tyre pedagogjike për të maksimizuar potencialin e IA-së në përmirësimin e të menduarit kritik, aftësive analitike dhe vlerësimin e tekstit letrar nga studentët.

Pyetjet kërkimore

1. Si ndikon integrimi i teknologjisë së inteligjencës artificiale (IA) në stilin e shkrimit dhe perceptimin e teksteve letrare tek studentët e gjuhës angleze në UNIKO?

2. Cilat janë sfidat dhe mundësitë që paraqet përdorimi i algoritmeve dhe platformave të IA-së në mësimdhënien dhe analizën e veprave letrare në nivel universitar, dhe si reagojnë studentët ndaj këtyre ndryshimeve teknologjike në studimin e letërsisë?

Organizimi i studimit

Përmbajtja e punimit do të përfshijë rishikim të literaturës, metoda dhe teknika, rezultatet dhe gjetjet, diskutim, rekomandime dhe përfundime. Do të diskutohet hollësisht ndikimi i inteligjencës artificiale në orët e letërsisë angleze të programit Bch. në “Gjuhë angeze”, në UNIKO, si dhe do të ndalemi në implikimet e tij, siç janë stili i shkrimit, mënyra se si lexuesit perceptojnë tekstet letrare, reagimet e studentëve dhe mundësitë e sfidat që IA sjell së bashku me sugjerime për studime dhe zbatime të mëtejshme.

Rishikimi i literaturës

Integrimi i IA-së në mësimdhënien e gjuhës së huaj
Futja e inteligjencës artificiale (IA) në mësimdhënien dhe të nxënët e gjuhës së huaj në nivel universitar ka sjellë ndryshime të mëdha. Huang et al. (2023) përshkruan se zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së IA-së ka nxitur përfshirjen e mjeteve dhe sistemeve IA në orët e gjuhës angleze si gjuhë e huaj (EFL) duke përmirësuar në mënyrë të dukshme rezultatet e të nxënët. Sipas Chen dhe Yuan (2022), integrimi i të dhënave në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë angleze mund të ndihmojë profesorët të identifikojnë metodat e duhura të mësimdhënies dhe informacionin më të vlefshëm. Mësimdhënësit përfitojnë nga algoritmet IA dhe nga analiza e të dhënave, të cilat u mundësojnë të ruajnë cilësinë e mësimdhënies, të ofrojnë përvoja të personalizuar të të nxënët dhe të përmbushin nevojat e ndryshme të studentëve. Platformat e të nxënët të mbështetura nga IA, krijojnë mundësi të reja dhe tërheqëse për të përjetuar dhe analizuar tekstet letrare. Ndërhyrjet e IA-së mund të parashtrajnë veprimtari praktike në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, duke u lejuar mësuesve të përqendrohen në analizën e thelluar të tekstit letrar dhe në zhvillimin e mendimit kritik nga ana e studentëve (Chen et al., 2020). Programet

mund të ofrojnë edhe vlerësime të automatizuara të eseve dhe rekomandime vetjake për lexime jashtëklase.

Në kontekstin e zhvillimit të teknologjisë së IA-së, mësuesit po kërkojnë mënyra të përshtatshme për të integruar mjetet dhe sistemet IA në mësimdhënien e gjuhës së huaj me fokus të veçantë letërsinë. Chen dhe Yuan (2022) theksojnë aftësinë e IA-së për të ndihmuar në mësimdhënien/nxënien e gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Kjo ndodh sepse IA mund të mbledhë dhe të analizojë të dhëna për të përcaktuar metodat më efektive për ofrimin e njohurive përkatëse. Mësuesit përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies duke përdorur algoritmet IA dhe analizën e të dhënave, ndërkohë që ofrojnë përvoja të reja, vetjake për studentët. Në kontekste të të nxënit të mbështetur nga IA, provat e të nxënit adaptiv krijojnë qasje të reja për t'i lidhur studentët me veprat letrare. Për sa i përket programeve të trajnimit, automatizimi IA merr përsipër detyrat administrative, ndërsa mësimdhënësit përqendrohen në zhvillimin e mendimit analitik dhe kritik (Chen et al., 2020). Këto ndërhyrje përfshijnë vlerësime automatike të eseve dhe sugjerime të personalizuara për lexime jashtëklase.

Përveç mësimit tradicional, me prani fizike, ballë për ballë, IA është e pranishme edhe në mësimdhënien e letërsisë në mjedise virtuale të të nxënit. Fitria (2021) fokusohet në përdorimin e IA-së në strategjitë e mësimdhënies/nxënies, veçanërisht në mësimin e gjuhës angleze. Interneti ofron aplikacione të shumta të mësimit të gjuhëve të mbështetura nga IA dhe mësues virtualë që ofrojnë reagime të menjëhershme dhe u lejojnë nxënësve të përvetësojnë gjuhën e dëshiruar. Këto materiale digjitale mundësojnë arsimim të pavarur dhe lexim të drejtuar individualisht të materialeve letrare, duke ofruar një alternativë për mësimin në klasë. Megjithatë, zbatimi i IA-së sjell edhe sfida për mësuesit e gjuhës së huaj, të cilët shpesh e kanë të vështirë të përshtasin metodat e tyre të mësimdhënies për të bërë mjediset e të nxënit me IA më efektive. Klimova et al. (2023) theksojnë se universitetet po integrojnë inteligjencën artificiale në mësimdhënien e gjuhës së huaj për të nxitur përfshirjen e studentëve, për të zhvilluar shijen letrare dhe për t'i pajisur ata me aftësitë e nevojshme për të përparuar me ritme të shpejta në një botë digjitale.

IA në mësimdhënien e aftësisë së të shkruarit

Inteligjenca artificiale (IA) është thelbësore në mësimdhënien e shkrimit akademik në gjuhën angleze. Dong (2023) diskuton efektet transformuese të pedagogjisë së bazuar në IA dhe sugjeron mënyra për të mësuar dhe vlerësuar studentët në mënyrë efektive. Duke theksuar veçantitë e shkrimit, identifikimin e zonave problematike dhe mundësinë e korrigjimeve të personalizuara, algoritmet e IA-së mund të ndihmojnë studentët në përmirësimin e aftësive të tyre në shkrim. Për më tepër, studentët mund të marrin menjëherë rekomandime për aspekte të veçanta gramatikore dhe stilistikore nga IA, duke i ndihmuar të shkruajnë punime akademike me cilësi më të lartë. Zhao (2023) shton se lektorët mund të përdorin teknologjitë IA për të konceptuar orë të ndryshme dhe të përshtatshme për shkrim, të cilat i përmbahen nevojave individuale dhe stileve të të nxëniet të studentëve.

Për më tepër, Khabib (2022) hulumton përdorimin e “tutorëve” digjitalë të shkrimit të bazuar në IA, duke marrë në shqyrtim shembuj të teksteve të shkruara akademike. “Tutorët” e IA-së mund të ndihmojnë në shkrimin e punimeve shkencore, redaktimin dhe formatimin, duke lehtësuar procesin e publikimit dhe duke rritur normën e rezultateve kërkimore. Duke përdorur mjetet e shkrimit të drejtuara nga IA për të kursyer kohën e mësimdhënësve për këto qëllime, shkrimi shkencor bëhet shumë më efektiv. Zhao dhe Nazir (2022) theksojnë se mjetet e fuqizuara nga IA për zbulimin e plagjiaturës u mundësojnë lektorëve të identifikojnë raste të plagjiaturës në punimet e studentëve dhe t'i korrigjojnë ato, duke ndihmuar në ruajtjen e standardeve të integritetit akademik. Me përparimin e teknologjisë, përmirësimi i mësimdhënies së shkrimit do të çojë në strategji krijuese të bazuara në IA për të ndihmuar përmirësimin e aftësive të shkrimit akademik dhe të aftësive komunikuese të studentëve (Cox, 2021).

IA dhe krijimi letrar

Ndërveprimi midis IA-së dhe letërsisë ka hapur një epokë të re inovacioni dhe kërkimi në fushën e rrëfimit dhe krijimit të teksteve letrare. Fang et al. (2023) shprehen se mjetet e shkrimit të përmbajtjes

së bazuar në IA kanë aftësinë për të krijuar tekste narrative në mënyrë të pavarur. Sistemet e IA-së mund të punojnë me databaza të mëdha të veprave letrare të siguruara nga botimet dhe të identifikojnë trende, madje të prodhojnë tregime të reja brenda kufijve të algoritmeve të krijimtarisë njerëzore. Sipas Khabib (2022), gjeneruesit e teksteve letrare të fuqizuara nga IA, që mbulojnë kanalet tradicionale të rrefimit dhe që ofrojnë mundësi të reja për motivim dhe kreativitet përmes përpunimit të gjuhës natyrore dhe të nxënësve përmes makinerisë, janë tani të gjetshme nga mësuesit dhe studentët. Duke shkuar më tej, Zhao (2023) argumenton se si studentët që mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të dytë (EFL) mund të aplikojnë teknologjinë e IA-së duke e përdorur atë si një asistent digjital për të përmirësuar kompetencën e të shkruarit. Këta studentë EFL mund të përdorin “tutorët” e shkrimit të bazuar në IA për të kapërcyer pengesat gjuhësore, për të prezantuar idetë e tyre në mënyrë më efektive dhe për të marrë reagime të menjëhershme për çështje gramatikore, zgjedhjet leksikore dhe formimin e fjalive. Zhai dhe Eiböo (2023) pohojnë se sistemet e IA-së mund të bashkëpunojnë me burimet njerëzore në zhvillimin e ideve krijuese, e elementeve të rrefimit, strukturës dhe ndërtimit të konfliktit. Duke përdorur inteligjencën artificiale në procesin e shkrimit krijues, studentët mund të gjejnë ide të reja për ndërtimin e tekstit letrar, të kapërcejnë vështirësitë në procesin e krijimit dhe të arrijnë nivele të larta krijimtarie që nuk i kishin imagjinuar më parë.

IA në të nxënësit e gjuhëve të huaja dhe zhvillimin e aftësive komunikuese

Përfshirja e IA-së në të nxënësit e gjuhëve të huaja është një qasje novatore që jo vetëm përmirëson nivelin e komunikimit të nxënësve, por edhe aftësinë e tyre gjuhësore. Rusmiyanto et al. (2023) përmendin aftësitë e IA-së në gjenerimin e ushtrimeve interaktive gjuhësore dhe në feedback-un e menjëhershëm, të cilat mund të rrisin aftësinë e komunikimit gjuhësor të një nxënësi. Përveç sistemeve të mësimin të gjuhës së huaj të mbështetura nga IA, studentët do të marrin pjesë në simulime bisedore interaktive, ushtrime të shqiptimit, teste komunikimi dhe të kuptimit të bazuara në kërkesat individuale.

Studentët e gjuhëve të huaja mund të përfitojnë më shumë nga mësimi përmes algoritmeve të IA-së të cilat monitorojnë përparimin dhe identifikojnë fushat e dobësive, duke ofruar reagime të menjëhershme për mënyrën se si një student zgjedh të komunikojë.

Po kështu, Moybeka et al. (2023) kanë argumentuar mbi efektin e IA-së në motivimin e studentëve të EFL (anglishtja si gjuhë e huaj), duke analizuar aspektet psikologjike të implementimit të IA-së në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Teknologjitë e IA-së mund t'i ndihmojnë studentët të mësojnë një gjuhë të huaj përmes "gamifikimit", duke e bërë mësimin më tërheqës për ta. Platformat e kontrolluara nga IA lejojnë vetëm pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari të përvetësimit të gjuhës. Si rezultat, studentët fitojnë besim për të vazhduar mësimin e gjuhës përmes testeve, sfidave gjuhësore dhe sistemeve të shpërblimit. "Tutorët" e IA-së mund të ndryshojnë metodat e tyre të mësimdhënies për t'u përshtatur me ritmin e çdo nxënësi dhe elementet e shpërblimit për të krijuar një mjedis të favorshëm dhe motivues për të mësuar. (Fitria, 2021). Mësuesit e gjuhëve të huaja mund të motivojnë studentët të mësojnë gjuhët, të nxisin vetëvlerësimin e studentëve dhe të ndihmojnë përvetësimin e gjuhës përmes teknologjisë së IA-së (Razack et al., 2021).

IA dhe mësimdhënia e përkthimit

Sot, në mësimdhënien e përkthimit të ndihmuar nga IA, konteksti në të cilin studentët mund të mësojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përkthim ka ndryshuar ndjeshëm. Wang (2023), në artikullin mbi përdorimin e IA-së në mësimdhënien e përkthimit të anglishtes në kolegji, pohon se IA do të ndihmojë në tejkalimin e pengesave gjuhësore dhe në përmirësimin e saktësisë së përkthimit. Mjetet e IA-së lehtësojnë të nxënësit e përkthimit: programet e memories së përkthimit dhe sistemet e përkthimit automatik ndihmojnë studentët të përkthejnë më shpejt dhe më saktë, duke shfrytëzuar të gjitha burimet gjuhësore dhe ndihmat e përkthimit automatik. Gayed et al. (2022) argumentojnë se softuerët e përkthimit të bazuar në IA mund të identifikojnë ekuivalentët përkthimorë, të krahasojnë tekste të ngjashme dhe të ofrojnë reagime të menjëhershme mbi rastet e

mundshme të përkthimit, duke përmirësuar më tej kapacitetet e përkthimit dhe duke thelluar të kuptuarit ndërkulturor.

Ghfar et al. (2023) theksojnë se, përveç teknologjive të IA-së, studiuesit po krijojnë sisteme reagimesh nga bashkëmoshatarët dhe projekte përkthimi bashkëpunues për të avancuar të nxënëtarë bashkëpunues dhe aftësinë e studentëve për të qenë krijues. Këto mjete përkthimi të mundësuar nga IA u lejojnë studentëve të bashkëpunojnë, të ndihmojnë njëri-tjetrin në përkthim, të ndajnë mendimet e tyre dhe të japin sugjerime konstruktive për kolegët e kursit. Kjo i ofron studentëve një mjedis studimi miqësor dhe mbështetës. Sistemet e përkthimit të bazuara në IA mundësojnë komunikimin ndërkulturor mes studentëve me prejardhje gjuhësore të ndryshme (Klimova et al., 2023). Me rritjen e përdorimit të IA-së, specialistët e përkthimit do të zhvillohen gradualisht për të krijuar mjedise novatore dhe gjithëpërfshirëse.

Sistemet e dialogut të IA-së dhe zhvillimi i kompetencës ndërvepruese

Teknologjia e Inteligjencës Artificiale (IA) përmirëson ndjeshëm aftësitë komunikuese të studentëve që mësojnë anglishten si gjuhë të huaj (EFL). Zhai dhe Wibowo (2023), përmes studimit të tyre mbi ndikimin e sistemeve të bisedës me IA tek aftësitë e komunikimit të studentëve EFL, theksojnë rëndësinë e rrugëve interaktive të të nxënitorit të gjuhës. Sistemet e dialogut virtual të bazuara në IA simulojnë situata të ngjashme me ato të bisedave të jetës reale, duke u mundësuar studentëve përmirësimin e aftësive të të folurit dhe përdorimit të gjuhës në kontekste reale. Sipas Moybeka et al. (2023), studentët zhvillojnë më tej aftësitë e të folurit, shprehjes dhe dëgjimit përmes ndërveprimeve me agentët e IA-së.

Raporti i Wang (2023) tregon se sistemet e dialogut me IA ofrojnë reagime të personalizuar dhe ndihmë gjuhësore, duke i ndihmuar studentët të identifikojnë gabime gramatikore, të përmirësojnë fjalorin dhe theksin. Për shembull, tutorët e bazuar në IA mund të korrigjojnë gabimet gjuhësore, të japin reagime të personalizuar bazuar në modelet e të folurit të studentëve dhe të ofrojnë tregues individualë të përparimit gjuhësor, pasi secili student ka nevojë të

ndryshme në mësimin e gjuhës. Sistemet e dialogut me IA gjithashtu përshtaten me stile dhe metoda të ndryshme të të nxëniet, duke ofruar një përvojë të personalizuar të të mësuarit, që i përshtatet çdo nxënësi (Liang et al., 2023). Mësimdhënësit mund të krijojnë mjedise tërheqëse mësimore duke përdorur sisteme të IA-së, për të nxitur pjesëmarrjen aktive, bashkëpunimin dhe komunikimin ndërkulturor (Zhao & Nazir, 2022). Sistemet e dialogut me IA kanë potencialin të transformojnë mësimin e gjuhës dhe t'i ndihmojnë studentët e avancuar të EFL-së të përmirësojnë aftësitë e tyre ndërvepruese, si në kontekste universitare, ashtu edhe në nivele më të larta.

Metodologjia e studimit

Struktura

Ky studim përdor metoda të kërkimit cilësor për të shqyrtuar ndikimin e IA-së në proceset e shkrimit dhe leximit në mësimdhënien e letërsisë në gjuhën angleze në UNIKO. Metoda cilësore është e përshtatshme për të siguruar një pamje të thellë dhe gjithëpërfshirëse të këtij fenomeni kompleks, duke analizuar se si studentët perceptojnë dhe reagojnë ndaj platformave të mbështetura nga IA të cilat përdoren për analizën dhe të kuptuarit e tekstit letrar. Kjo metodë është thelbësore për të eksploruar stilin e të shkruarit, këndvështrimin dhe përvojën e studentëve, duke u fokusuar në ndikimin që IA ka mbi ta. Ky studim synon të zbulojë trendet e integritit të IA-së në mësimdhënien e letërsisë në gjuhën angleze. Rezultatet do të jenë të vlefshme për drejtuesit e IAL, studiuesit dhe mësimdhënësit për të përcaktuar rregulloret dhe praktikat më të mira për integrimin e mjeteve të IA-së në mësimdhënien e anglishtes si gjuhë e huaj.

Kampioni

Pjesëmarrësit e studimit janë 36 studentë të ciklit të parë dhe të dytë që aktualisht ndjekin kurset e letërsisë angleze në UNIKO, si dhe disa të diplomuar së fundmi. Këta studentë kanë përvoja të ndryshme jetësore dhe aftësi të ndryshme në fushën e studimeve letrare. Në këtë studim do të përdoret metoda e kampionimit të rastësishëm për përzgjedhjen e studentëve pjesëmarrës. Duke përfshirë një numër të kufizuar pjesëmarrësish, studimi do të ofrojë një kuptim modest të

ndikimit të IA-së në proceset e të shkruarit dhe leximit në kurrikulën e letërsisë angleze. Përfshirja e studentëve nga kultura dhe përvoja të ndryshme do të ndihmojë në thellimin e analizës se si teknologjia IA ndikon në mënyrën e të shkruarit, interpretimin e teksteve letrare dhe përvojën e të nxënit të studentëve.

Mbledhja e të dhënave

Për të mbledhur të dhënat e nevojshme, pjesëmarrësve të studimit do t'u jepen pyetje të hapura përmes anketave me dhjetë pikë. Këto pyetje do t'u dërgohen me email studentëve dhe do të kenë një afat njëmuor për dorëzim. Pyetjet e hapura do të lejojnë një analizë më të thelluar të opinioneve, angazhimit dhe reagimeve të studentëve ndaj platformave dhe mjeteve të mundësuar nga IA që përdoren në mësimin e letërsisë angleze, disa prej të cilave do të kontribuojnë në studim në mënyrë cilësore. Kjo metodë e mbledhjes së të dhënave do të aplikohet për të marrë informacion të plotë se si inteligjenca artificiale ndikon në zhvillimin e aftësisë të shkrim-leximit të studentëve të gjuhës angleze në UNIKO.

Të drejtat, privatësia dhe anonimiteti i pjesëmarrësve do të mbrohen përmes respektimit të akteve të brendshme në UNIKO. Protokollin e kërkimit do të përputhet me kërkesat etike dhe do të garantojë anonimitetin e subjekteve dhe respektimin e të drejtës për të marrë pjesë. Rekrutimi do të jetë vullnetar dhe pjesëmarrësit do të kenë mundësi të japin gjykime të pandikuara nga palë të tjera.

Rezultatet

Përmbledhje e gjetjeve

- Ndikimi në stilin e të shkruarit: Të shkruarit me ndihmë të IA 24 studentë pohuan se kishin përvojë me përdorimin e mjeteve të IA në korigjimin e gabimeve gramatikore dhe stilistikore.

- Të menduarit: Ndërkohë që 11 studentë besonin se IA do të frenonte aftësinë krijuese, të tjerë pohuan se platformat IA mund të ndihmojnë në zhvillimin e ideve të reja dhe në kapërcimin e pengesave në shkrim.

- Perceptimi i teksteve letrare: Të kuptuarit dhe analiza 29 pjesëmarrës deklaruan se mjetet IA përmirësuan kuptimin dhe interpretimin e teksteve letrare duke ofruar informacione mbi idetë, personazhet dhe strukturat narrative.

- Originaliteti: Pavarësisht përfitimeve, 28 studentë kishin dyshime në lidhje me integritetin e analizave të prodhuara nga IA, duke theksuar rëndësinë e ndërveprimit kritik me këto informacione. Feedback-u i studentëve Angazhimi dhe motivimi 28 studentë që përdorën mjetet e mbështetura nga IA raportuan se ishin më të motivuar dhe të angazhuar, veçanërisht gjatë punës në grupe dhe kur merrnin reagime nga bashkëstudentët.

- Besimi dhe autonomia: Me ndihmën e mjeteve të IA-së, 15 studentë raportuan se mund të shkruanin me më shumë besim dhe pavarësi, çka i motivoi drejt të mësuarit të pavarur.

- Sfida dhe mundësi: Varësia nga teknologjia Një çështje e rëndësishme që u vërejt ishte mundësia e varësisë së tepruar nga teknologjia IA, e cila mund të dëmtojë aftësitë e mendimit kritik dhe të rezultojë në një stil më pasiv në shkrimin dhe analizën e tekstit letrar.

- Përshtatje pedagogjike: Mësuesit e sapodiplomuar kuptuan se për të integruar me sukses mjetet e IA në analizën e tekstit letrar, ishte e nevojshme një përshtatje pedagogjike, duke theksuar rëndësinë e ofrimit të mbështetjes dhe drejtimit në përpunimin e informacionit të marrë nga IA.

Këto të dhëna do të ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve të rëndësishme në lidhje me përfshirjen e mjeteve të mbështetura nga IA në kurrikulat e programeve të studimit në UNIKO. Përgjigjet e të anketuarve tregojnë se përdorimi i IA-së në plotësimin e detyrave të ngarkuar, ka ndikuar ndjeshëm në stilin e shkrimit të studentëve. Ata pohojnë se pajisjet e mundësuar nga IA, të cilat ofrojnë sugjerime dhe korrigjime stilistike, u kanë shërbyer për të përmirësuar aspekte të ndryshme gramatikore, koherencën dhe qartësinë e fjalive të përdorura. Një tjetër aspekt ku vërehet ndikimi pozitiv i IA është ndihma në vjeljen e ideve krijuese dhe kapërcimin e pengesave në të shkruar, duke u ofruar studentëve një botë të re të mendimit krijues.

Studimi tregon gjithashtu se këto teknologji po u ofrojnë lexuesve një kuptim më të thellë të tematikës, karakterizimit dhe strukturave letrare përmes interpretimit me ndihmën e informacioneve të IA. Rezultatet ngritën gjithashtu pyetje mbi natyrën e vërtetë të analizave të gjeneruara nga IA, duke nënvizuar rëndësinë e vlerësimit kritik të tyre. Këto gjetje përkrahin domosdoshmërinë e informacioneve që ndihmojnë studentët të mendojnë në mënyrë kritike për të dhënat e prodhuara nga IA dhe t'i përdorin krahas njohurive të tyre.

Nga ana tjetër, rezultatet e këtij studimi tregojnë rritje të shkallës së motivimit, angazhimit, pavarësisë dhe vetëbesimit të studentëve gjatë procesit të shkrimit, si përgjigje ndaj zbatimit të IA-së në mësimdhënien e letërsisë. Studentët nxorën në pah rolin e mjeteve të fuqizuara nga IA në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të fuqizuar të të nxënësve. Megjithatë, pengesat kryesore për arritjen e rezultateve të plota lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe nevojën për përshtatje pedagogjike.

Informacionet e mbështetura në IA po ndryshojnë stilin e të shkruarit dhe interpretimet letrare të teksteve në orët e gjuhës angleze. Studimi tregoi se mbështetja tek IA ka reduktuar ndjeshëm gabimet dhe pasaktësitë në shkrim, duke përmirësuar aftësitë e studentëve në të shkruar. Me mundësinë e vlerësimit në kohë reale të detyrave të shkruara, IA lehtëson punën e studentit, duke përmirësuar kështu aftësitë e përgjithshme. Përdorimi i IA-së për detyra krijuese dhe për analizën letrare e thellon kërkimin në fushën e literaturës. Një element kyç është roli i feedback-ut në drejtpeshimin e përdorimit të IA-së me zhvillimin e kreativitetit individual.

Rezultatet tregojnë gjithashtu ndikimin pozitiv të IA-së në motivimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në klasë. Studentët që përdorin programe të bazuara në IA shfaqin më shumë motivim dhe angazhim, siç kanë vërejtur Moybeka et al. (2023). Kështu, përfshirja e mjeteve të IA-së ka rritur vetëbesimin dhe pavarësinë e studentëve gjatë procesit të të shkruarit, duke reflektuar ndikimin motivues të IA-së në të nxënësit e gjuhës (Rusmiyanto et al., 2023).

Përkundër përfitimeve, varësia nga teknologjia dhe nevoja për përshtatje pedagogjike mbeten disa nga pengesat. Për këtë arsye, përdorimi i IA-së duhet të shoqërohet me metodat tradicionale në

mësimdhënie për të zhvilluar të menduarit kritik dhe të pavarur të studentëve.

Rekomandime

Mësimdhënësit në UNIKO duhet të përdorin pajisjet e IA-së për të përmirësuar metodat e mësimdhënies. Për të fuqizuar studentët që të angazhohen në lexim kritik dhe të zhvillojnë kreativitetin dhe pavarësinë në shkrim, procesi duhet të përfshijë mbështetje dhe udhëzime. Për këtë, profesionistët e fushës së arsimit duhet të pajisen me shkathhtësi digjitale dhe aftësitë e duhura pedagogjike përmes trajnimeve nga specialistët e fushës (Gayed et al., 2023).

UNIKO duhet të përqendrohet në kërkim dhe inovacion në metodat e bazuara në IA për të nxitur partneritete ndërmjet mësimdhënësve, studiuesve dhe zhvilluesve të teknologjisë. Kjo mund të arrihet përmes zhvillimit të qendrave kërkimore ndërdisiplinore që adresojnë IA-në dhe edukimin letrar (Ëang, 2023). Institucioni duhet të krijojë bashkëpunime me ofruesit kryesorë të teknologjisë IA për të zhvilluar zgjidhje të përshtatura me nevojat e edukatorëve dhe studentëve.

Përfundime

Në përgjithësi, përfshirja e IA-së në arsim ka ndikuar në mësimdhënie. Ky studim ofron njohuri modeste mbi ndikimin e IA-së në mësimdhënien e letërsisë angleze në UNIKO, duke treguar se IA mund të përmirësojë aftësitë e shkrimit, analizën letrare, pjesëmarrjen dhe motivimin e studentëve. Megjithatë, varësia teknologjike dhe nevoja për përshtatje pedagogjike bëjnë të nevojshme një qasje të balancuar, ku mjetet e IA-së plotësojnë, dhe jo të zëvendësojnë, metodat tradicionale të mësimdhënies. UNIKO duhet të përqendrohet në kërkime dhe zhvillime të bazuara në IA në fushën e edukimit si pjesë e veprimtarisë së tij kërkimore dhe inovative, në bashkëpunim me mësimdhënës, studiues dhe zhvillues të teknologjisë. Qëllimi është të përdoret IA për të përmirësuar procesin e të nxënësve, për të promovuar të menduarit kritik dhe për të ndihmuar studentët të bëhen lexues analitikë dhe nxënës gjatë gjithë jetës, përmes kërkimeve akademike, zhvillimit profesional dhe lidhjeve me industrinë.

Studimi tregon se IA ka ndikime pozitive dhe negative në mësimdhënien e gjuhës angleze. Nga ana tjetër, ai u ofron mësimdhënësve, studiuesve dhe politikëbërësve rekomandime të dobishme për mënyrën se si IA mund të mbështesë në mënyrë efektive procesin e të nxënit dhe arritjet e studentëve. UNIKO duhet të vlerësojë kreativitetin, të menduarit kritik dhe cilësinë e arsimit, duke zbatuar metoda të përmirësuara me IA për të adresuar sfidat e një mjedisi të udhëhequr nga teknologjia. Kjo qasje ndihmon universitetin të kapërcejë hendekun digjital. Përmes kërkimit, inovacionit dhe bashkëpunimit, UNIKO do të hapë rrugën që IA të ndikojë në mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor në të ardhmen. Kështu, IA do të jetë një mjet thelbësor për të rivlerësuar pozitën e Arsimit të lartë në Shqipëri.

Bibliografi

Chen, L., Chen, P., & Lin, Z. (2020). Artificial intelligence in education: A review. *Ieee Access*, 8, 75264-75278.

<https://ieeexplore.ieee.org/stamp/stamp.jsp?arnumber=9069875>.

Chen, M., & Yuan, Z. (2022). Teaching mode of English language and literature based on artificial intelligence technology in the context of big data. *Mobile Information Systems*, 2022, pp. 1-11. <https://doi.org/10.1155/2022/1275368>.

Cox, A. M. (2021). Exploring the impact of Artificial Intelligence and robots on higher education through literature-based design fictions. *International Journal of Educational Technology in Higher Education*, 18(1), p. 3. <https://doi.org/10.1186/s41239-020-00237-8>.

Dong, Y. (2023). Revolutionizing academic English writing through AI-powered pedagogy: practical exploration of teaching process and assessment. *Journal of Higher Education Research*, 4(2), p. 52. <https://doi.org/10.32629/jher.v4i2.1188>.

Fang, X., Ng, D. T. K., Leung, J. K. L., & Chu, S. K. W. (2023). A systematic review of artificial intelligence technologies used for story writing. *Education and Information Technologies*, 28(11), 14361-14397. <https://doi.org/10.1007/s10639-023-11741-5>.

- Fitria, T. N. (2021). The use technology based on artificial intelligence in English teaching and learning. *ELT Echo: The Journal of English Language Teaching in Foreign Language Context*, 6(2), 213-223. e-ISSN: 2549-5089.
- Gayed, J. M., Carlon, M. K. J., Oriola, A. M., & Cross, J. S. (2022). Exploring an AI-based writing Assistant's impact on English language learners. *Computers and Education: Artificial Intelligence*, 3, 100055.
<https://doi.org/10.1016/j.caeai.2022.100055>.
- Ghafar, Z. N., Salh, H. F., Abdulrahim, M. A., Farxha, S. S., Arf, S. F., & Rahim, R. I. (2023). The role of artificial intelligence technology on English language learning: A Literature Review. *Canadian Journal of Language and Literature Studies*, 3(2), pp. 17-31. <https://doi.org/10.53103/cjlls.v3i2.87>.
- Huang, X., Zou, D., Cheng, G., Chen, X., & Xie, H. (2023). Trends, research issues and applications of artificial intelligence in language education. *Educational Technology & Society*, 26(1), 112-131. [https://doi.org/10.30191/ETS.202301_26\(1\).0009](https://doi.org/10.30191/ETS.202301_26(1).0009).
- Khabib, S. (2022). Introducing artificial intelligence (AI)-based digital writing assistants for teachers in writing scientific articles. *Teaching English as a Foreign Language Journal*, 1(2), pp. 114-124. <https://doi.org/10.12928/tefl.v1i2.249>.
- Klimova, B., Pikhart, M., Polakova, P., Cerna, M., Yayilgan, S. Y., & Shaikh, S. (2023). A systematic review on the use of emerging technologies in teaching English as an applied language at the university level. *Systems*, 11(1), p. 42. <https://doi.org/10.3390/systems11010042>.
- Liang, J. C., Hwang, G. J., Chen, M. R. A., & Darmawansah, D. (2023). Roles and research foci of artificial intelligence in language education: an integrated bibliographic analysis and systematic review approach. *Interactive Learning Environments*, 31(7), 4270-4296. <https://doi.org/10.1080/10494820.2021.1958348>.
- Moybeka, A. M., Syariatina, N., Tatipang, D. P., Mushthoza, D. A., Dewi, N. P. J. L., & Tineh, S. (2023). Artificial intelligence and English classroom: The implications of AI toward EFL students'

- motivation. *Edumaspul: Jurnal Pendidikan*, 7(2), 2444-2454. ISSN: 2580-0469.
- Nazari, N., Shabbir, M. S., & Setiawan, R. (2021). Application of Artificial Intelligence powered digital writing assistant in higher education: randomized controlled trial. *Heliyon*, 7(5). <https://doi.org/10.1016/j.heliyon.2021.e07014>.
- Razack, H. I. A., Mathew, S. T., Saad, F. F. A., & Alqahtani, S. A. (2021). Artificial intelligence-assisted tools for redefining the communication landscape of the scholarly world. *Science Editing*, 8(2), pp. 134-144. <https://doi.org/10.6087/kcse.244>.
- Rusmiyanto, R., Huriati, N., Fitriani, N., Tyas, N. K., Rofi'i, A., & Sari, M. N. (2023). The role of artificial intelligence (AI) in developing English language learner's communication skills. *Journal on Education*, 6(1), pp. 750-757. E-ISSN: 2654-5497.
- Wang, Y. (2023). Artificial intelligence technologies in college English translation teaching. *Journal of psycholinguistic research*, 52(5), pp. 1525-1544. <https://doi.org/10.1007/s10936-023-09960-5>.
- Zhai, C., & Wibowo, S. (2023). A systematic review on artificial intelligence dialogue systems for enhancing English as foreign language students' interactional competence in the university. *Computers and Education: Artificial Intelligence*, 4, 100134. <https://doi.org/10.1016/j.caeai.2023.100134>.
- Zhao, Q., & Nazir, S. (2022). English multimode production and usage by Artificial Intelligence and online reading for sustaining effectiveness. *Mobile Information Systems*, 2022. <https://doi.org/10.1155/2022/6780502>.
- Zhao, X. (2023). Leveraging artificial intelligence (AI) technology for English writing: Introducing wordtune as a digital writing assistant for EFL writers. *RELC Journal*, 54(3), pp. 890-894. <https://doi.org/10.1177/00336882221094089>.

INTEGRIMI I HAPËSIRËS MEDIATIKE TË PODKASTIT NË PROGRAMIN E HISTORISË DHE QYTETËRIMIT AMERIKAN

Olsa Pema

olsa.pema@yahoo.com

1. Hyrje

Ky punim fokusohet në integrimin e podkastit mësimor, si një mjet novator në hapësirën mediatike të mësimdhënies së gjuhës së huaj, më konkretisht të Historisë dhe Qytetërimit Amerikan në nivel

universitar e më gjerë. Teknologjitë moderne të mësimdhënies si dhe burimet e internetit, sigurisht, kanë zgjeruar ndjeshëm mundësitë e organizimit të procesit të të mësuarit të gjuhës së huaj, duke i mundësuar studentit marrjen e informacionit të përditësuar dhe autentik rreth një tematike dhe duke e lejuar atë të zhytet në një mjedis unik gjuhësor që nxit përparimin e aftësive komunikuese e social-kulturore të tij. Përdorimi i këtij potenciali zgjeron jo vetëm kufijtë, por edhe shkallën e aksesueshmërisë dhe nivelin e mësimdhënies së gjuhës së huaj me praninë e një mjeti teknologjik që rezonon përtej kontekstit fizik.

Bashkë me burime të tjera të internetit, interes të veçantë paraqet mjeti novator i podkastit, i cili përmes karakterit mediatik mund të shërbejë si një mjet mësimor integral që u jep zgjidhje problematikave komplekse në kontekstin e zhvillimit jo vetëm të kompetencave gjuhësore por edhe kulturore. Aplikimi i këtij mjeti është tregues i posaçëm i zhvendosjes të krejt modelit të sistemit arsimor në ditët tona në përpjekje për t'iu përshtatur kërkesave në ndryshim të vazhdueshëm të shoqërisë globale.

Fjala “podcast” në anglisht është produkt i pranëvendosjes së fjalëve “ipod” + “broadcast”. Pra, termi “podcasting” nënkupton një formë transmetimi në trajtë audio ose video informative në internet. Integrimi i podkastit po gjen gjithmonë e më tepër hapësirë sidomos përgjatë mësimdhënies në distancë veçanërisht në nxitjen e kompetencës dëgjimore, duke e bërë këtë mjet lehtësisht të aksesueshëm në çdo kohë e vend.

Gjatë mësimdhënies së gjuhës së huaj, në përputhje me nivelin gjuhësor, objektin apo edhe kontekstin e orës, podkastet mësimore të huazuara nga hapësira mediatike mund të vijnë në formë leksionesh, bashkëbisedimesh në trajtë interviste, lajme apo formate të tjera që lidhen domosdoshmërisht me qëllimet edukative të parashikuara në kurrikul.

2. Vlefshmëria e podkasteve mësimore gjatë mësimdhënies së Historisë e Qytetërimit Amerikan në ciklin universitar

Ky punim paraqet një përpjekje për të integruar podkastin mësimor si mjet përgjatë orës në auditor dhe përtej saj për të lehtësuar dhe rritur standardin e mësimdhënies së Historisë dhe Qytetërimit Amerikan, si dhe për të pasuruar kompetencat kulturore – komunikative të studentëve të degës së Gjuhës angleze, kursi II, programi *Bachelor*. Janë konceptuar në detaj disa orë të integruara leksion – seminar që trajtojnë ngjarje të rëndësishme në historinë e Amerikës dhe në funksion të secilës orë vihet në dispozicion nga një podkast i posaçëm mësimor drejtuar nga folës vendas të specializuar në fushën e historisë amerikane dhe mësimdhënies së saj prej nga studentët informohen në mënyrë të pjesshme për çështje të një tematike përgjatë segmenteve të caktuara mësimore. Studentët punojnë më tej me aktivitete të krijuara posaçërisht prej meje mbështetur tek materialet audio/video si dhe finalizojnë punën me produktet e tyre, të cilat publikohen në vijimësi.

Ky konceptim i punës mësimore mendoj se ka mjaft përparësi krahasuar jo vetëm me mësimdhënien tradicionale, por edhe në raport me mjete të tjera teknologjike për disa arsye:

Së pari, përmes podkastit mundësohet ekspozimi i vazhdueshëm i studentëve ndaj materialeve autentike përgjatë procesit mësimor dhe kjo nënkupton tërësinë e ngjarjeve të dokumentuara, të strukturave e fjalorit, kodeve të komunikimit si dhe tipareve të tjera kulturore që mbart gjithë procesi i komunikimit nga një folës vendas specialist i një fushe të caktuar. Detyra e një podkasti autentik është pikërisht nxitja e aftësive njohëse dhe komunikative me të cilat studenti do të ballafaqohet në jetën reale. Krahas podkasteve autentike, vlerë kanë edhe ato të krijuara nga metodistët në përputhje me nivelin dhe qëllimet për të ndihmuar orientimin komunikativ - gjuhësor të studentëve përgjatë procesit të të mësuarit.

Së dyti, sistemi i podkasteve përmes gjerësisë apo larmisë së fushave që mbulohen prej tij, mundëson lidhjet tematike. Në rastin tonë për çdo temë historike – kulturore nga *syllabus*-i mund të servirim veprimtari të po asaj sferë me integrimin e podkastit. Kjo patjetër rrit efektshmërinë e mësimdhënies pasi njohuria relevante e marrë me podkast mund të shërbejë si plotësues, thellues apo përditësues i

informacionit të marrë në leksion, të cilin e pasuron dhe e rindërton në mënyrë kritike.

Së treti, keto mjete dallohen për funksionet e tyre të shumëfishta që lidhen me nxitjen e gjithë tipeve të veprimtarive ligjërimore. Kështu, duke punuar mbi një podkast, studentët krahas dëgjimit, kanë mundësi edhe të lexojnë, por edhe të krijojnë ligjërata në formë dialogu, diskutimi apo monologu vetjak si dhe të shkruajnë në të. Për më tepër, kjo lloj zhytjeje në aktivitet u mundëson atyre edhe zhvillimin e kompetencës socio-kulturore, e cila zhvillohet paralelisht me elementet e tjera të gjuhës – dhe kjo përbën një vlerë të shtuar veçanërisht në modulën e historisë dhe qytetërimit amerikan.

Së katërti, duke zgjedhur tipa të ndryshëm podkastesh me video dhe audio, mundësojmë në të njëjtën kohë aktivizimin e shqisave të ndryshme dhe, për rrjedhojë, rritim kapacitetin marrës nga ana e studentit. Dhe, përtej kësaj, njohuria e marrë përpunohet më në thellësi dhe kuptohet më lehtë e më në thelb prej studentit.

Së pesti, planet mësimore me podkaste lejojnë studentët t'i aksesojnë ato nga mjete të ndryshme, qofshin këta celularë, tableta, kompjutera, apo projektorë, duke mundësuar zgjerimin e mjedisit të të nxëniet me përdorimin e tyre edhe përtej klasës fizike, duke i krijuar studentit përparësi në drejtim të zhvillimit të aftësive personale marrëse pa ndikim të drejtpërdrejtë të aktorëve të tjerë.

Për më tepër, studentët mund të krijojnë produktet e tyre në mënyrë të pavarur duke nxitur kreativitetin dhe produktivitetin në procesin mësimor duke dëshmuar një aspekt mjaft të dobishëm të punës në podkast, siç është fleksibiliteti i përdorimit të tij gjatë dhe përtej punës në auditor. Gjatë punës për zhvillimin e orëve në modulën e Historisë e Qytetërimit Amerikan është marrë parasysh ky element, duke shfrytëzuar hapësirat pedagogjike novatore të podkasteve mësimore.

3. Përfundime

Nisur nga konceptimi i strukturës së disa orëve mësimore në lëndën e Historisë e Qytetërimit Amerikan me në fokus podkastin dhe refleksionet mbi potencialin e vlefshmërisë së këtij mjeti gjatë procesit mësimor, mund të pohohet se mjetet e teknologjisë mediatike në përgjithësi paraqesin potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm,

hapësirat e tyre në zgjerim krijojnë avantazhe dhe lehtësi të domosdoshme për procesin e mësimdhënies së historisë e qytetërimit, duke u nisur nga bashkëkohorësia, autenticiteti, këndvështrimi i pasur historik, metodat e larmishme të analizës së ngjarjeve historike që nxitin mendimin kritik e krijues. Sidoqoftë, të gjitha këto mbeten për t’u eksploruar konkretisht rast pas rasti, pasi përbëjnë prirje apo nisma relativisht të reja. Nga përvoja si specialiste e doktoruar në fushën e mësimdhënies së kompetencave gjuhësore e kulturore përmes TIK mendoj se çdo prurje e re e teknologjisë mediatike zgjon interes të veçantë te studentët brenda e përtej lëndës, pasuron fondin e materialeve me funksion njohës e informues, ndihmon studentët të zhvillojnë kompetencat ndërkulturore përmes teknikës së ekspozimit dhe përjasjes, si dhe të orientojnë organizimin e kohës së tyre duke perceptuar më mirë realitetet kulturore, të vetorganizohen, të punojnë në mënyrë të pavarur duke u përfshirë në projekte e veprimtari që do t’i ndihmojnë të bëhen me kompetentë në lëndën në fjalë, por edhe të zbulojnë më tej veten në përputhje me prirjet e talentet.

Bibliografia

- Atay, D., Kurt G., Çamlıbel, Z., Ersin, P., & Kaslioglu, Ö.(2009), The Role of Intercultural Competence in Foreign Language Teaching. Inonu University Journal of the Faculty of Education, 10/3, 123-135.
- Blake, R. J. (2008), Brave New Digital Classroom – Technology and Foreign Language Learning, Washington D.C., George Town University Press.
- Brown, H. D. (2007), Teaching by Principles: An Interactive Approach to Language Pedagogy, San Francisco. Pearson Education ESL.
- Byram, M.(1997), Teaching and Assessing Intercultural Communicative Competence. Clevedon: Multilingual Matters.
- Byram, M. dhe Tost Planet, M.(2001),Social identity and European dimension. Intercultural Competence through Foreign Language Learning. Graz: Council of Europe.
- Douglas, B. (1998), History of the United States - American Heritage, NY., Viking.
- Pema, O. dhe Xhinaku E. (2019), American Civilization –A Topical Guide, Shqipëri, Promo Print sh.p.k.

- Pennington, M. (1995), The Teacher Change Cycle. TESOL Quarterly, völl. 29/4, 705-731.
- Rheingold, H. (1993). The Virtual Community, Homesteading on the Electronic Frontier. Cambridge: The MIT Press.
- Richards, J. C. (1993), Beyond the Text Book: The Role of Commercial Materials in Language Teaching. RELC Journal, 24/1, 1-14.
- Schulz, R. A. (2007), The Challenge of Assessing Cultural Understanding in the Context of Foreign Language Instruction. Foreign Language Annals, 40(1), 9-26.
- Teeler D., Gray P. (2001), How to Use the Internet in ELT, Pearson Education Limited.
- Titova S., (2009), Information and communication technologies in humanitarian education: theory and practice. Textbook, Moscow, P-Center.
- Turkle, Sh. (1996). Life on the Screen. Identity in the Age of the Internet. New York: Touchstone.
- Warschauer, M. (1996), Virtual Connections: Online Activities and Projects for Networking Language Learners, Honolulu, HI: University of Hawaii Second Language Teaching and Curriculum Center.
- Veselova V., (2015), Formation of listening skills through the use of podcasts in the educational process, Science of SUSU, 1029-1035.
- American History Tellers Podcast:
<https://podcasts.apple.com/us/podcast/american-history-tellers/id1313596069>.

NDIKIMI I MEDIAVE NË SHKRIMIN AKADEMIK

Dorela Kaçani

dkonomi@unkorce.edu.al

Ndikimi i mediave në shkrimin akademik është bërë një temë e rëndësishme studimi, veçanërisht me përhapjen gjithnjë e më të madhe të teknologjisë së dhe platformave të rrjeteve sociale në arsim. Marrëdhënia midis mediave dhe shkrimit akademik është shumëdimensionale, duke përfshirë aspekte të tilla si rolin e rrjeteve sociale në formësimin e praktikave të shkrimit dhe ndikimet për integritetin akademik.

Një nga mënyrat kryesore në të cilat mediat ndikojnë në shkrimin akademik është përmes integritetit të teksteve multimodale. Siç vëren Archer (2010), tekstet akademike gjithnjë e më shumë mbështeten në bashkëprezencën e shkrimit dhe materialeve grafike, ku imazhet shërbejnë si bartës të rëndësishëm të kuptimit në disiplina të ndryshme. Ky trend reflekton një ndryshim më të gjerë drejt njohjes së vlerës së formave jo të shkruara të shprehjes në kontekste

akademike, siç thekson Gourlay (2016), i cili argumenton se teksti i shkruar tradicional nuk duhet të dominojë diskursin akademik. Përdorimi i elementeve vizuale jo vetëm që pasuron përmbajtjen, por gjithashtu përputhet me praktikën bashkëkohore të shkrim-leximit që theksojnë rëndësinë e multimodalitetit në komunikim (Huang & Archer, 2017).

Për më tepër, rritja e rrjeteve sociale ka transformuar mënyrën se si studentët angazhohen me shkrimin akademik. Hulumtimi i Sriwichai (2022) tregon se platformat e rrjeteve sociale mund të përdoren me efektivitet për të përmirësuar të kuptuarit e studentëve për shkrimin akademik dhe jo-akademik. Për shembull, ushtrimet e zhvilluara në platforma si WhatsApp kanë treguar se fuqizojnë studentët duke i ndihmuar ata të njohin dhe të shmangin gabimet e zakonshme në shkrim, duke përmirësuar kështu aftësitë e tyre në shkrimin akademik. Në mënyrë të ngjashme, Songxaba dhe Sincuba (2019) theksojnë ndikimin e gjuhës së rrjeteve sociale në shkrimin e studentëve, duke sugjeruar se gjuha informale e përdorur në këto platforma shpesh depërton në kontekste akademike, duke sjellë gabime të padëshiruara në shkrimin formal. Ky fenomen thekson nevojën që mësuesit të adresojnë ndikimin e rrjeteve sociale në zakonet e shkrimit të studentëve dhe të ofrojnë udhëzime për ruajtjen e standardeve akademike.

Ndikimet e këtyre ndryshimeve përfshijnë edhe qasjet pedagogjike të përdorura në mësimdhënien e shkrimit akademik. Siç vëren Clarence (2012), shkrimi akademik nuk është thjesht një aftësi, por një praktikë sociale e formësuar nga konventat e disiplinave të caktuara. Kjo perspektivë kërkon një rivlerësim të mësimdhënies së shkrimit për të përfshirë praktikën e ndryshme të shkrim-leximit që studentët hasin në jetën e tyre digjitale. Për shembull, integrimi i mekanizmave të reagimit online, siç eksplorohet nga Collett dhe Dison (2019), mund të lehtësojë mjedisin e të nxënësve bashkëpunues, ku studentët marrin reagime formuese për shkrimin e tyre. Këto qasje jo vetëm që përmirësojnë aftësitë e shkrimit, por gjithashtu krijojnë një ndjenjë komuniteti ndërmjet studentëve, që është thelbësore për zhvillimin e literaturës akademike.

Ndryshimet e vazhdueshme në shkrimin akademik, të ndikuara veçanërisht nga mediat dhe teknologjitë digjitale, kërkojnë një rivlerësim të qasjeve pedagogjike në mësimdhënien e kësaj aftësie kritike. Ndërsa mësuesit përshtaten me këto ndryshime, dalin disa tema kyçe, duke përfshirë integrimin e praktikave multimodale, përfshirjen e shkrim-leximit digjital, theksimin e të nxënit bashkëpunues dhe nevojën për zhvillimin e mendimit kritik dhe integritetit akademik.

Më poshtë, janë renditur ndikimet e tyre në mësimdhënien e shkrimit akademik, të mbështetura nga referenca të rëndësishme shkencore.

1. Integrimi i praktikave multimodale

Zhvendosja drejt teksteve multimodale—ku shkrimi plotësohet me elemente vizuale, zanore dhe interaktive—ka ndikime të mëdha për mësimdhënien e shkrimit akademik. Kërkimet tregojnë se studentët përfitojnë nga ekspozimi ndaj mënyrave të ndryshme të komunikimit, të cilat mund të përmirësojnë të kuptuarit dhe angazhimin e tyre me përmbajtjen akademike. Për shembull, Kress dhe van Leeuwen (2001) argumentojnë se kuptimi ndërtohet përmes burimeve të ndryshme semiotike dhe, si pasojë, mësimi i shkrimit akademik duhet të përfshijë edhe aftësitë vizuale përveç aftësive tradicionale të shkrimit (Archer, 2010). Kjo qasje jo vetëm që përgatit studentët për kërkesat e diskursit bashkëkohor akademik, por gjithashtu i inkurajon ata të mendojnë në mënyrë kritike rreth mënyrave të ndryshme që mund të përdoren për të përcjellë kuptimin në mënyrë efektive.

2. Përfshirja e shkrim-leximit digjital

Ndërsa platformat digjitale bëhen të domosdoshme për komunikimin akademik, nevoja për shkrim-lexim digjital në mësimdhënien e shkrimit akademik është e domosdoshme. Aftësia për të naviguar burimet online, për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve dhe për të ndjekur praktikat etike në shkrim është thelbësore për studentët në epokën digjitale. Sipas Buckingham (2003), edukimi në shkrim-leximin mediatik duhet të jetë një komponent thelbësor i kurrikulës, duke i pajisur studentët me aftësitë për të analizuar në mënyrë kritike mesazhet e mediave dhe për të kuptuar implikimet e tyre (Gourlay, 2016). Duke integruar shkrim-leximin digjital në kurset e shkrimit akademik, mësuesit mund të ndihmojnë studentët të zhvillojnë

kompetencat e nevojshme për shkrimin efektiv në një kontekst digjital.

3. Theksimi i të nxënit bashkëpunues

Natyra bashkëpunuese e shumë platformave digjitale ofron mundësi për të nxënit në grup dhe për dhënien e reagimeve në shkrimin akademik. Hulumtimi i Liu dhe Sadler (2003) thekson përfitimet e proceseve të shqyrtimit nga kolegët, ku studentët angazhohen në shkrim dhe kritikë bashkëpunuese, që çon në përmirësimin e rezultateve të shkrimit dhe një kuptim më të thellë të konventave akademike (Huang & Archer, 2017). Mësuesit mund të përdorin mjetet online, si forumet e diskutimit, dokumentet bashkëpunuese dhe platformat e shqyrtimit nga kolegët për të lehtësuar këtë proces. Duke krijuar një mjedis të të nxënit bashkëpunues, studentët mund të zhvillojnë aftësitë e tyre të shkrimit, ndërsa gjithashtu mësojnë të vlerësojnë perspektiva të ndryshme dhe reagime konstruktive.

4. Zhvillimi i mendimit kritik dhe integritetit akademik

Në mjedisin digjital, është e lehtë të hasësh në burime të ndryshme të informacionit, që ndonjëherë mund të jenë të pasakta ose mashtruese. Prandaj, është thelbësore që studentët të zhvillojnë mendimin kritik dhe të dinë të bëjnë dallimin midis burimeve të besueshme dhe atyre jo të besueshme. Hulumtimi i Sutherland-Smith sugjeron se platformat e rrjeteve sociale dhe faqet e internetit të lajmeve shpesh paraqesin informacion të pjesshëm ose të manipuluar, duke e bërë të rëndësishme që studentët të kenë aftësi të forta për të vlerësuar burime (Sutherland-Smith 2016) t. Mësuesit mund të luajnë një rol kritik në zhvillimin e këtyre aftësive duke përfshirë detyra që sfidojnë studentët të analizojnë dhe të kritikojnë informacionin që gjejnë në mediat digjitale.

5. Përshatja e praktikave të vlerësimit

Ndryshimet në shkrimin akademik kërkojnë një rivlerësim të praktikave të vlerësimit. Vlerësimet tradicionale, që fokusohen vetëm në produktet përfundimtare të shkruara, mund të mos kapin në mënyrë të drejtë kompleksitetin e proceseve të shkrimit të studentëve në një kontekst multimodal dhe dixhital. Siç vërehet nga, vlerësimet formuese që ofrojnë reagime të vazhdueshme dhe mundësi për rishikim mund të mbështesin më mirë mësimin dhe rritjen e

studentëve me shkrim (Songxaba & Sincuba, 2019). Edukatorët duhet të konsiderojnë përfshirjen e një sërë metodash vlerësimi, duke përfshirë portofolet dixhitale, shkrimin reflektues dhe vlerësimet e kolegëve, për të ofruar një vlerësim më të plotë të aftësive të të shkruarit të studentëve.

Për më tepër, epoka dixhitale ka ngritur shqetësime në lidhje me integritetin akademik, veçanërisht në lidhje me plagjiaturën dhe format e tjera të sjelljes së keqe akademike. Sutherland-Smith diskuton se si interneti ka mundësuar forma të ndryshme të pandershmerisë akademike, të tilla si mashtrimi i kontratës dhe marrëveshjet e fshehta, duke paraqitur gjithashtu mundësi për shkrimin bashkëpunues dhe ndarjen e njohurive (Sutherland-Smith, 2016). Ky dualitet nxjerr në pah nevojën që edukatorët të rrenjosin një ndjenjë të fortë integriteti akademik tek studentët, duke theksuar rëndësinë e atribuimit të duhur dhe praktikave etike të shkrimit.

Përveç këtyre sfidave, nuk mund të anashkalohet edhe roli i edukimit mediatik në formësimin e shkrimit akademik të studentëve. argumentojnë se edukimi i shkrim-leximit mediatik është thelbësor për pajisjen e studentëve me aftësitë e nevojshme për t'u angazhuar në mënyrë kritike me forma të ndryshme mediatike (Fedorov et al., 2016). Duke nxitur edukimin mediatik, edukatorët mund t'i ndihmojnë studentët të lundrojnë në kompleksitetin e komunikimit dixhital dhe të zhvillojnë një kuptim më të nuancuar se si media ndikon në praktikat e tyre të të shkruarit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një epokë ku informacioni është lehtësisht i aksesueshëm dhe aftësia për të dalluar burimet e besueshme është parësore.

Për më tepër, kryqëzimi i shkrimit akademik dhe formimit të identitetit është një fushë e rëndësishme e kërkimit. Hulumtimi i Wu tregon se kontekstet në internet ndikojnë ndjeshëm në praktikat e shkrim-leximit të studentëve dhe ndjenjën e tyre të identitetit (Wu, 2010). Ndërsa studentët angazhohen me media të ndryshme, ata negociojnë me identitetin e tyre si shkrimtarë dhe nxënës, gjë që mund të ndikojë në performancën e tyre akademike. Ky ndërveprim dinamik ndërmjet medias, identitetit dhe shkrimit nënvizon rëndësinë

e krijimit të mjediseve mësimore gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse që pranojnë prejardhjet dhe përvojat e ndryshme të studentëve.

Ndërsa peizazhi i shkrimit akademik vazhdon të evoluojë, është thelbësore që mësuesit të përshtatin strategjitë e tyre të mësimdhënies për të pasqyruar këto ndryshime. theksojnë nevojën për të integruar praktikat e shkrimit disiplinor në mësimdhënien e përmbytjes akademike, duke rritur kështu angazhimin e studentëve në ndërtimin e njohurive (Hunter & Tse, 2013). Duke e përafëruar mësimin e shkrimit me kërkesat specifike të disiplinave të ndryshme, edukatorët mund t'i përgatisin më mirë studentët për kompleksitetin e shkrimit akademik në fushat e tyre përkatëse.

Në përfundim, ndikimi i mediave në shkrimin akademik është i dukshëm dhe i pashmangshëm. Është thelbësore të adoptohen qasje pedagogjike që njohin praktikat e ndryshme të shkrim-leximit të studentëve dhe që zhvillojnë një ndjenjë të fortë të integritetit akademik. Duke vepruar kështu, ata mund t'i pajisin studentët me aftësitë e nevojshme për të lulëzuar në një mjedis akademik gjithnjë e më kompleks.

Përfundime

Ndikimet në shkrimin akademik shtrihen përtej procesit të shkrimit vetë; ato kërkojnë një ndryshim themelor në qasjet pedagogjike. Duke integruar praktikat multimodale, duke theksuar shkrim-leximin digjital, duke nxitur të nxënit bashkëpunues, duke promovuar integritetin akademik dhe duke përshtatur metodat e vlerësimit, mësuesit mund të përgatisin më mirë studentët për kompleksitetin e shkrimit akademik në epokën digjitale. Ndërsa ky peizazh i komunikimit vazhdon të zhvillohet, është thelbësore që mësuesit të mbeten të përgjegjshëm ndaj këtyre ndryshimeve dhe t'i pajisin studentët me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për sukses në përpjekjet e tyre akademike. Kjo panoramë gjithëpërfshirëse e ndryshieve të mediave në pedagogjinë e shkrimit akademik nënvizon nevojën që mësuesit të përshtatin strategjitë e tyre të mësimdhënies për të përmbushur kërkesat e një peizazhi akademik në ndryshim të shpejtë.

Bibliografia

- Archer, A. (2010). Multimodal texts in higher education and the implications for writing pedagogy. *English in Education*, 44(3), 201-213. <https://doi.org/10.1111/j.1754-8845.2010.01073.x>
- Buckingham, D. (2003). *Media Education: Literacy, Learning and Contemporary Culture*. Polity Press.
- Clarence, S. (2012). Making inter-disciplinary spaces for talk about and change in student writing and literacy development. *Teaching in Higher Education*, 17(2), 127-137
<https://doi.org/10.1080/13562517.2011.611876>.
- Collett, K. and Dison, A. (2019). Decentering and recentering the writing centre using online feedback: towards a collaborative model of integrating academic literacies development. *Stellenbosch Papers in Linguistics Plus*, 56(0). <https://doi.org/10.5842/57-0-811>
- Fedorov, A., Levitskaya, A., & Calandria, E. (2016). Curricula for media literacy education according to international experts. *European Journal of Contemporary Education*, 17(3). <https://doi.org/10.13187/ejced.2016.17.324>
- Gourlay, L. (2016). Multimodality, argument and the persistence of written text., 79-90. https://doi.org/10.1163/9789004312067_006
- Huang, C. and Archer, A. (2017). 'Academic literacies' as moving beyond writing: investigating multimodal approaches to academic argument. *London Review of Education*, 15(1). <https://doi.org/10.18546/lre.15.1.06>
- Hunter, K. and Tse, H. (2013). Making disciplinary writing and thinking practices an integral part of academic content teaching. *Active Learning in Higher Education*, 14(3), 227-239. <https://doi.org/10.1177/1469787413498037>
- Kress, G., & van Leeuwen, T. (2001). *Multimodal Discourse: The Modes and Media of Contemporary Communication*. Oxford University Press.
- Liu, J., & Sadler, R. (2003). The Effect of Peer Review on Students' Writing. *Assessment & Evaluation in Higher Education*, 28(3), 263-275.
- Songxaba, S. and Sincuba, L. (2019). The effect of social media on english second language essay writing with special reference to whatsapp. *Reading & Writing*, 10(1).

<https://doi.org/10.4102/rw.v10i1.179>

Sriwichai, C. (2022). The use of social media text-based exercises to promote university students' knowledge of non-academic and academic english language. Arab World English Journal, 13(3), 296-310. <https://doi.org/10.24093/awej/vol13no3.19>

Sutherland-Smith, W. (2008). Plagiarism, the Internet and Student Learning: A Survey of the Literature. Journal of University Teaching & Learning Practice, 5(1), 1-11.

Sutherland-Smith, W. (2016). Academic integrity in the digital age: introduction., 571-573. https://doi.org/10.1007/978-981-287-098-8_82

Wu, H. (2010). Multimodal literacy practice and identity in standard english learning: a case study in taiwan. The Jalt Call Journal, 6(2), 129-142. <https://doi.org/10.29140/jaltcall.v6n2.97>

RËNDËSIA E PËRFSHIRJES SË EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN NË SOCIOLINGUISTIKË

Lindita Kaçani

lkacani@unkorce.edu.al

Lënda “Sociolinguistikë” është një lëndë e përfshirë në programin “Bachelor – Gjuhë Angleze”. Lënda zhvillohet në semestrin e dytë, të vitit të tretë. Ngarkesa e lëndës është 3 kredite, të konvertuara në 15 orë leksione dhe 22 orë seminare. Sociolinguistika ka të bëjë me të kuptuarit e përdorimit të gjuhës në kontekstin e saj social dhe kulturor. Gama e dukurive me të cilat merren sot sociolinguistët është e gjerë: dygjuhësia, ndërrimi i kodit apo përzjerja e gjuhëve gjatë komunikimit, kompetenca komunikuese (aftësia për të përdorur gjuhën në komunikim me një qëllim të caktuar), natyra dhe funksioni i bisedave (ndërveprimet verbale), dialektet dhe sociolektet (variantet geografike dhe shoqërore të një gjuhe), të shprehurit e mirësjelljes dhe solidaritetit përmes gjuhës, studimi se si gjuha kodon dhe, nga ana tjetër, formon shoqërinë dhe perceptimet lidhur me gjininë, moshën, klasën shoqërore, identitetin, përkatësinë etnike dhe racën (Wardhaugh, 2006). Njohuritë teorike, të marra përmes leksioneve,

ilustrohen përmes dhënies së shembujve nga gjuhë dhe situata të ndryshme komunikimi çka nxit studentët të ndërveprojnë në klasë duke sjellë opinionin dhe përvojën e tyre në përdorimin e një ose më shumë gjuhëve.

Edukimi mbi Median dhe Informacionin (EMI), një pedagogji ku media përbën objektin e të mësuarit, shihet e rëndësishme për tu integruar në mësimin e Sociolinguistikës, veçanërisht në ditët e sotme të zhvillimit teknologjik ku njerëzit me prejardhje të ndryshme gjuhësore, shoqërore, arsimore, gjeografike dhe kulturore kanë investuar në teknologjitë e komunikimit dhe janë përdorues të rregullt të tyre; si rrjedhojë studentët e gjejnë veten më të përfshirë në orën mësimore dhe më të përgjegjshëm në procesin e mësimnxënies. Duke patur parasysh se çfarë përfshin termi 'media', mjetet tradicionale dhe ato bashkëkohore të epokës digjitale të realizimit dhe përhapjes së informacionit [siç janë: shtypi i shkruar (libri, gazeta, revista), radioja, televizioni, kompjuteri, tableti, blogu, apo website të ndryshme që përdorin kode të shkruara apo/edhe dëgjimore], studentët, mësuesit apo interesues të tjerë të të kuptuarit e përdorimit të gjuhës në kontekstin e social dhe kulturor, do të gjejnë tek diskursi mediatik gjuhën dhe përdorimin e saj autentik. Si e tillë, gjuha e medias përbën një mjet të dobishëm e të rëndësishëm në mësimdhënien e gjuhës (amtare dhe të huaj) dhe studimit të saj (Leitner, 2007) përfshirë dhe në lëndën e "Sociolinguistikës"; përfshirja e gjuhës mediatike "live", të pamonitoruar, synon të njohë studentet me varietetet e gjuhës angleze (Leitner, 2007). Gjithashtu në media gjejmë përdorimin standard dhe jo standard të gjuhës; në rastin e parë, përdoruesit dhe studiuesit e gjuhës e lidhin atë me ndjenjën e identitetit dhe përkatësisë gjuhësore; ndërsa në rastin e e dytë, mësuesi dhe studentët gjejnë material për të ilustruar, diskutuar dhe mbajtur qëndrime ndaj përdorimeve jo standarte të gjuhës, korrektësisë dhe normave gjuhësore.

Njohja me konceptet bazë të EMI-t ndihmon studentët në lëndën e Sociolinguistikës të përshkruajnë dhe analizojnë bashkëjetesën dhe ndërveprimin e tyre në jetën shoqërore (Deumert, 2014). Gjithashtu aftësimi i studentëve përmes edukimit mediatik për të dekonstruktuar dhe kuptuar qartë një mesazh, për të identifikuar, përshkruar dhe

analizuar një tekst apo ligjërim mediatik ka një rëndësi të veçantë, pasi shërbejnë si një bazament në funksion të analizës sociolinguistike të materialit mediatik.

Përfshirja e tre modeleve mësimore të integritit të EMI-t në lëndën e “Sociolinguistikës”, si më poshtë, pasqyron me tepër rëndësinë e integritit të këtyre dy disiplinave:

- Integrimi i teknikave të EMI-it në studimet e etnografisë së ligjëritit në Sociolinguistikë

- Përshkrimi dhe analiza e përdorimit simetrik dhe asimetrik të termave të adresimit në tekste apo ligjëtime të ndryshme.

- Analizimi i përmbajtjes mediatike në funksion të analizës sociolinguistike të ligjëtimeve politike.

Përmes integritit të EMI-t në sociolinguistikë, studentet mund të zhvillojnë:

- aftësitë e tyre në përdorimin e teknologjisë dhe mediave digjitale në mënyrë optimale dhe të kuptojnë se si funksionojnë ato;

- qëndrimin e tyre kritik për median, përmbajtjen mediatike dhe aktorët që i prodhojnë dhe shpërndajnë ato;

- aftësitë e tyre informuese, identifikuese, përshkruese, analizuese dhe krahasuese përmes hulumtimit të informacionit;

- aftësitë dalluese, si: të dallojë një fakt nga një opinion, të kontekstualizojë dhe vlerësojë informacionin, si ndryshon gjuha në varësi të karakteristikave shoqërore të komunikuesve, të karakteristikave të situatës së komunikimit, kanalit të komunikimit, përmbajtjes së informacionit dhe, faktorëve të tjerë shoqëror në procesin e komunikimit masiv (Isroil, 2023; McKay, 2011).

Zhvillimi i aftësive të mësipërme do të çojë në zhvillimin e aftësive të tjera madhore në jetën e studentit jashtë klase:

- Të shprehurit me gojë ose me shkrim në përshtatje me situatën e komunikimit.

- Të krijojë forma dhe kuptime të reja gjuhësore (Tankosić & Dovchin, 2021).

- Të menduarit kritik

- Aftësitë bashkëpunuese (si: të qëndruarit mendjehapur, të qenit organizues, përshtatja me të tjerët në grup, të dëgjuarit aktiv, apo menaxhues i mirë i kohës).

Si përfundim mund të theksojmë që përfshirja e EMI-t në lëndën “Sociolinguistikë” mundëson dhe aftëson studentët të kuptojnë, analizojnë dhe interpretojnë nga këndvështrimi sociolinguistik në mënyrë më të thellë dhe të suksesshme përmbajtjen e tekstit apo ligjëritit të gjetur apo krijuar në burime të ndryshme të medias tradicionale dhe ato bashkëkohore të epokës digjitale.

Literaturë

Deumert, A. (2014). 1 Media sociolinguistics. In *Sociolinguistics and Mobile Communication* (pp. 1-8). Edinburgh: Edinburgh University Press. <https://doi.org/10.1515/9780748655755-004>

Isroil, M. (2023). Sociolinguistic analysis of media language: publicistic text development. *EPRA International Journal of Multidisciplinary Research*, 9 (3).

McKay, S. (2011). Language and the media. In R. Mesthrie (Ed.), *The Cambridge Handbook of Sociolinguistics* (pp. 396–412). Cambridge: Cambridge University Press.

Tankosić, A., & Dovchin, S. (2021). The impact of social media in the sociolinguistic practices of the peripheral post-socialist contexts. *International Journal of Multilingualism*, 20(3), 869–890. <https://doi.org/10.1080/14790718.2021.1917582>

Wardhaugh, R. (2006). *An Introduction to Sociolinguistics*. Blackwell Publishing.

NDIKIMI DHE ROLI I MEDIAS DHE RRJETEVE SOCIALE NË GJUHË DHE KULTURË - NDRYSHIMI GJINOR NË PERCEPTIMIN MEDIATIK

Lorena Robo

lrobo@unkorce.edu.al

Studimet e shumta kanë treguar se ndikimi i medias në shoqëri veçanërisht tek brezi i ri kanë ndryshuar mënyrën e të sjellurit dhe të perceptuarit të gjerave në jetën e përditshme. Nëse krahasojmë të rrinjtë e sotëm me të rrinjtë e disa brezave më parë vemë re ndryshime në mënyrën e jetesës, mënyrën e të menduarit, perceptimin për jetën, shkathësinë në përdorimin e teknologjisë. Afrimi i brezit të ri me teknologjinë ka lehtësuar dhe ofruar mjaft komoditete në jetën e gjithësecilit. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale po ashtu ka sjellë risi në shoqërinë e sotme, ka ofruar shpejtësi në të menduar duke ekzekutuar detyra nga më të thjeshtat deri te ato më komplekse duke përfshirë të mësuarit, arsyetimin dhe perceptimin, ka reduktuar 'gabimin njerëzor', ofron asistencë digjitale, vendime të shpejta, ofron besueshmëri. Por, nga ana tjetër sjell si pasojë dembelizëm, mungesë emocionesh, aftësi jo menduese, ulje të të menduarit kritik dhe aftësi kreative të individit.

Në botën e sotme, mediat sociale po luajnë një rol të domosdoshëm në sjelljen mësimore të studentëve të universitetit për të arritur arsim

të qëndrueshëm. Ndikimi i mediave sociale në edukimin e qëndrueshëm po bëhet një faktor thelbësor dhe nxitës. Bota është bërë një fshat global dhe përdorimi i teknologjisë e ka bërë atë një botë më të vogël përmes mediave sociale dhe mënyrës se si po ndryshon udhëzimet. Është gjithnjë e më e dukshme që faqet e rrjeteve sociale dhe aplikimet e tyre paraqesin përfitime të mëdha, si dhe rreziqe për studentët e universitetit dhe implikimet e tyre në përshtatjen psikologjike të studentëve ose sjelljet e të mësuarit nuk janë kuptuar mirë.

Në epokën moderne, mediat sociale dhe rrjetet sociale ndikojnë në mënyrë drastike në komunitetin e studentëve, dhe një teknologji e tillë po bëhet gradualisht një pjesë e përditshme e jetës së çdo individi në shoqërinë moderne. Inovacionet po ndodhin me shpejtësi në fushën e teknologjive të informacionit dhe po prezantohen përmes mediave të shumta sociale dhe faqeve të rrjeteve. Për shembull, Facebook, LinkedIn, Tëitter dhe ËhatsApp ofrojnë modele të reja të ndërveprimit social të komunikimit, dhe disa nga këto metoda të komunikimit nuk janë as të drejtuara dhe as të ndërsjella. Në të vërtetë, përdoruesit e mediave sociale mund të lexojnë ose shohin postimet në internet, të vetë-publikuara të miqve të tyre pa ndërveprim të drejtpërdrejtë me ata miq.

Media sociale i referohet teknologjisë së ndërmjetësuar nga kompjuteri që lehtëson rritjen dhe ndarjen e ideve, ndërgjegjësimit, interesave të karrierës, informacionit dhe metodave të tjera të shprehjes përmes rrjeteve sociale dhe komuniteteve virtuale. Përmbajtja e krijuar nga përdoruesit e mediave sociale, të tilla si komentet, postimet, fotot dixhitale, ndarja e videove dhe të gjitha të dhënat e ndërveprimit në internet, janë kritike dhe përfaqësojnë gjakun jetësor të rrjeteve sociale dhe faqeve të mediave sociale. Përdoruesit e mediave sociale zakonisht aksesojnë shërbimet e mediave sociale nëpërmjet internetit ose teknologjive të tjera të bazuara në ueb në laptopët ose kompjuterët e tyre desktop ose duke shkarkuar aplikacione që zgjerojnë funksionalitetin e mediave sociale dhe rrjeteve sociale në pajisjet mobile, të tilla si telefonat inteligjentë ose tabletët. Si rezultat i angazhimit me shërbime të tilla, përdoruesit e mediave sociale zakonisht krijojnë platforma shumë ndërvepruese

përmes të cilave studentë individualë ose organizata studentore mund të ndajnë ide, të bashkëkrijojnë, modifikojnë dhe diskutojnë përmbajtjen e krijuar nga përdoruesit ose përmbajtjen e mëparshme të postuar në internet. Mediat sociale drejtojnë mjetet e komunikimit midis studentëve dhe individëve të tjerë, komuniteteve dhe organizatave të mëdha, dhe ndryshime të tilla janë fokusi kryesor i fushave në zhvillim dhe inovative të teknologjive të informacionit. Rrjetet sociale përfaqësojnë një strukturë shoqërore që shfaq cilësimet e ndryshme të aktorëve socialë - individët, komunitetet dhe organizatat - dhe përfshin ndërveprimet sociale dhe komunikimet e atyre aktorëve socialë. Megjithatë, rrjetet sociale të bazuara në ueb dhe përhapja e mediave sociale kanë rritur gjithashtu depresionin tek studentët dhe kanë ndryshuar në mënyrë drastike atmosferën sociale në të cilën zhvillohen dhe mësojnë studentët.

Komunikimi është një mënyrë ndërveprimi me komunitete dhe individë të ndryshëm që janë të ndryshëm nga vetvetja, dhe është i domosdoshëm për të vlerësuar dhe kuptuar pikëpamjet e ndryshme të llojeve të ndryshme të njerëzve. Kështu, mjediset tradicionale shoqërore, duke përfshirë komunitetet, kishat, shkollat, grupet e ndryshme vullnetare, organizatat dhe vendet e punës, janë vende vendimtare për njerëzit që të ndërveprojnë dhe të komunikojnë me individë heterogjenë. Në mjedisin e mediave dixhitale dhe sociale, ka më shumë mundësi për t'u angazhuar me njerëz me perspektiva të ndryshme, dhe platforma të tilla ofrojnë lloje të ndryshme të shkëmbimit të informacionit dhe mjete të shkëmbimit të opinionëve, ideve dhe pikëpamjeve me njerëz të tjerë. Disa studime të kohëve të fundit kanë ekzaminuar se si mediat sociale dhe platformat e tjera në internet lehtësojnë ndërveprimet dhe komunikimet me lloje të ndryshme njerëzish - një fenomen i quajtur heterogjeniteti i rrjetit.

Ndikimi i medias dhe rrjeteve sociale në edukim

Mediat sociale kanë ndryshuar mënyrën se si përdoruesit e saj komunikojnë dhe përdorin faqet e bazuara në internet si një mjet për shpërndarjen e përmbajtjes midis mediave dixhitale dhe përdoruesve të internetit. Ajo ka krijuar mundësi për promovime më të përballueshme dhe shumë të qëndrueshme në internet të mallrave dhe

shërbimeve, ofron mënyra të reja për të trajtuar dhe koordinuar ndërveprimet midis përdoruesve të mundshëm të mediave sociale dhe ka nxitur krijimin e mundësive të biznesit dhe korrespondencës së sistemit. Në mënyrë të vazhdueshme, një numër i madh i përdoruesve të mediave sociale shpërndajnë artikujt, fotografitë, videot dhe regjistrimet e tyre me ndihmën e platformave të mediave sociale, si Facebook, WhatsApp, Viber, YouTube, Flickr dhe WordPress, dhe ata ndajnë informacione të tilla me të tjerët. Kohët e fundit, ka pasur një debat mbi ndikimin negativ të përdorimit të mediave sociale tek njerëzit, veçanërisht tek adoleshentët dhe komunitetet studentore në mbarë botën. Në këtë drejtim, mediat dixhitale dhe faqet e rrjeteve sociale kanë marrë kritika.

Sot, studentët po mbështeten gjithnjë e më shumë në informacione dhe të dhëna që janë lehtësisht të aksesueshme në faqet e rrjeteve sociale dhe në internet. Kjo është arsyeja pse aftësitë e të nxënësve dhe aftësitë kërkimore të studentëve po bien në situata të caktuara, pasi angazhimi i tyre me këto faqe redukton fokusin e tyre, gjë që i bën ata t'i kushtojnë më pak kohë studimeve të tyre dhe rezulton në një rënie të performancës së tyre akademike. Në mënyrë tipike, ndërsa studentët shpenzojnë më shumë kohë në mediat sociale, ata shpenzojnë më pak kohë duke u shoqëruar ballë për ballë ose personalisht me njerëz të tjerë, dhe këto zakone ulin aftësitë e tyre të komunikimit. Humbja e kohës së studentëve në mediat sociale gjithashtu mund t'i bëjë ata të humbasin afatet me raste. Si rezultat, studentët mund të mos jenë në gjendje të komunikojnë dhe të socializohen në mënyrë efektive personalisht, dhe dihet mirë se aftësitë e forta komunikuese janë çelësi i suksesit. Për më tepër, përdorimi i tepërt i mediave sociale ndikon në shëndetin mendor dhe fizik të studentëve. Nxënësit vonojnë vaktet e tyre dhe nuk pushojnë siç duhet; në vend të kësaj, ata konsumojnë sasi të tepërta çaji ose kafeje për të qëndruar vigjilent dhe aktiv. Ky stil jetese ka efekte negative në shëndetin mendor dhe fizik të nxënësve. Për më tepër, përdorimi i tepruar i përditshëm i mediave sociale është i pashëndetshëm, sepse u mundëson studentëve të shmangin krijimin e lidhjeve ballë për ballë me njerëzit. Prindërit janë përgjegjës për monitorimin e përdorimit të mediave sociale nga fëmijët e tyre dhe

ata duhet të jenë vigjilentë nëse fëmijët e tyre përdorin internetin për një kohë të përshtatshme. Tek e fundit, edukatorët dhe bashkëmoshatarët janë gjithashtu përgjegjës për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë efektet negative të mediave sociale në shëndet dhe ata duhet t'i bëjnë studentët të vetëdijshëm për atë që mund të humbasin në botën reale kur kalojnë shumë kohë në faqet e mediave sociale.

Studimet kanë zbuluar se përdorimi i mediave sociale ka një lidhje me shëndetin mendor tek studentët e rinj. Studentet femra treguan më shumë simptoma të depresionit sesa meshkujt. Përdorimi i tepërt i mediave sociale mund të shkaktojë depresion, stres dhe ankth tek studentët dhe mund të rrisë ngacmimin kibernetik, humbjen e kohës dhe rreziqet shëndetësore në jetën e një studenti.

Sipas një sondazhi të vitit 2015 mbi ndikimet e mediave sociale në sjelljen sociale të studentëve në SHBA, 60% e të rinjve përdorin mediat sociale 2 orë në ditë. Në fund të fundit, përdorimi i tepërt i mediave sociale është i lidhur në mënyrë lineare me izolimin social në jetën reale dhe ndikon negativisht në sjelljen sociale. Deri në shkurt 2017, përdorimi i Snapchat kishte arritur 79% të angazhimit midis brezave të rinj. Në Hong Kong, pothuajse 96% e njerëzve që përdorin telefona inteligjentë shfletojnë internetin çdo ditë, që është përqindja më e lartë në vendet aziatike.

Disa tema mbi ndikimin e medias në gjuhë dhe kulturë janë pasqyruar te syllabusi i lëndës Gjuhë dhe Kulturë, i cili jepet në vitin e tretë, prej tri kreditesh në programin e studimit Bachelor “Gjuhë angleze”. Janë paraqitur temat si më poshtë:

1. Culture as knowledge, social identity; you are what you know, EMI influence
2. Education, media, and information (EMI) importance on language and culture
3. The influence of media in the language used in radio and TV
4. Media impact on culture
5. Main principles of media communication
6. Media analyses and their role in language and communication
7. A future agenda for research on language and culture. EMI impact on new perspectives of language change.

Temat janë shtrirë në katër leksione, përkatësisht java 11, 12, 13 dhe 14. Tema e parë trajton aspektin teorik mbi kulturën, identitetin social, ndikimin e medias mbi gjuhën dhe kulturën, si formëson, ndikimi i gjuhës së medias të përdorur në radio dhe television, impakti i medias në kulturë. Java e dytë trajton principet thelbësore të komunikimit mbi median, analizën mbi median dhe rolin e tyre në gjuhë dhe komunikim. Studentët vëzhgojnë për tre ditë median në televizion kryesisht emisione, show-bize, etj. Ata ndahen në grupe me nga tre studentë dhe secilit grup i jepet një kanal televiziv i caktuar, psh., Top-channel, Klan, Vizion +. Emisionet televizive u jepen të zgjidhen nga vetë ata me qëllim evidentimin e rolit të medias në formësimin e jetës së përditshme të tyre. Si ndikon zhvillimi mediatic në elaborimin gjuhësor të shoqërisë, sa evidente është gjuha e huaj, termat e përdorur në ligjërimin e folësve televizivë? Sa ndikon ajo në kulturën dhe gjuhën shqipe?

Java e tretë lidhet me një axhendë kërkimore të ndikimit të gjuhës dhe kulturës në të ardhmen, perspektivat e trajtimit të ndryshimëve gjuhësore si pasojë e ndikimit dhe evoluimit gjuhësor mediatic. Java e katërt pasohet nga një projekt me temë “Research papers/ projects on EMI importance on language, EMI and culture reflection on media and cultural stereotypes”, të realizuara në javën 15. Studentet hulumtojnë mbi stereotipet kulturore dhe barazinë gjinore, analizojnë reflektimin e tyre në media, ndikimin e aspektit kulturor në të gjithashtu. Studentët fokusohen mbi emisione, TV-show, dokumentare, radio duke analizuar ndikimin e kulturës në gjuhë e veçanërisht ndikimin e gjuhëve të huaja në ligjërimin mediatic. Sot ndikimi i gjuhëve të huaja është shumë i madh në botën televizive aq shumë sa po harrohët përdorimi i termave shqipe në ligjerimin e përditshëm. Kjo vihet re në gjuhën e politikanëve, në gjuhën e spikereve televizivë, në gazeta, revista e kudo. A mund të mendohet ky fenomen si trend i kohës apo duhet parë me një sy kritik dhe shqetësues për humbjen e vlerave dhe termave në gjuhën shqipe? A mos vallë nuk e dinë gazetarët dhe politikanët që të mospërdorurit e termave të huaj i bën ata më pak tërheqës për publikun a më pak të kuptueshëm për ta? Mos ndoshta po humb vlera e gjuhës shqipe? Çfarë ndodh me shtresën e tretë të popullsisë? Lind pyetja sa përqind

të fjalorit të përdorur kuptohet prej tyre? Studimi fokusohet mbi evidentimin e termave të huaj në gjuhë, ndikimin e kulturave të tjera në gjuhën shqipe dhe ku shihet e ardhmja e gjuhës shqipe sot?

Përfundime

Mediat (gazetat, radio, televizioni) dhe teknologjitë e reja janë pjesë e kulturës dhe shoqërisë. Pranohet gjerësisht se mediat janë përcjellës të kulturës dhe motorët e globalizimit të kulturave. Në vendet me dendësi të madhe mediash, nuk ka asnjë aspekt të shoqërisë në të cilin mediat nuk kanë ushtruar ndikimin e tyre, ndonëse në shkallë të ndryshme. Përhapja e mediave, shpërthimi i teknologjive të reja dhe dalja në skenë e mediave sociale në shumë pjesë të botës, kanë ofruar burime të shumfishta për qasje në informacion dhe njohuri që lidhen me gjininë. Mediat informative, pavarësisht nga teknologjia që përdorin, vazhdojnë të jenë një nga burimet kryesore të informacionit, ideve dhe opinionëve për shumicën e njerëzve anembanë botës. Ndonëse në strukturat shoqërore dhe në mendjet e njerëzve ekzistojnë pabarazi dhe stereotipe gjinore, mediat kanë potencialin t'i shumëfishojnë e përkeqësojnë, apo t'i përmirësojnë ato. Për më tepër, tendenciozitetet e vetëdijshme ose të pavetëdijshme që bartin ndonjëherë shumë profesionistë të medias, qofshin burra apo gra, ndaj këndvështrimeve kufizuese dhe të njëanshme maskiliste, vjen pjesërisht nga mungesa e kapaciteteve për të raportuar më gjerë për gratë dhe çështjet gjinore.

Mediat sociale janë një mjet mbështetës për studentët gjatë procesit të të mësuarit dhe janë të dobishme edhe për edukatorët. Megjithatë, mësuesit dhe prindërit janë këshilluar që të mbajnë një ekuilibër të shëndetshëm kur lejojnë përdorimin e mediave sociale, pasi përdorimi i tepruar mund të rezultojë në efekte negative të nxënësit. Mediat sociale kanë ndikime pozitive dhe negative në proceset e të mësuarit të studentëve dhe rekomandohet një qasje e ekuilibruar gjatë përdorimit të aplikacioneve të mediave sociale. Aspektet pozitive të mediave sociale përfshijnë kontributin e saj teknik në institucionet arsimore dhe disa industri, si shëndetësia, shërbimet, turizmi dhe komunitetet. Karakteristikat pozitive përfshijnë ndarjen e mendimeve me të tjerët; ngritja e ndërgjegjësimit; ndarjen e njohurive; ndërtimi i

marrëdhënieve, identitetit, reputacionit dhe kontakteve; përmirësimi i ndikimit shoqëror dhe zhvillimin e aftësive të tjera të komunikimit.

Referenca

Birim, B. Evaluation of Corporate Social Responsibility and Social media as Key Source of Strategic Communication. *Procedia Soc. Behav. Sci.* 2016, 235, 70–75.

Hardy, B.W.; Castonguay, J. The moderating role of age in the relationship between social media use and mental well-being: An analysis of the 2016 General Social Survey. *Comput. Hum. Behav.* 2018, 85, 282–290.

Martin, J.N.; Nakayama, T.K. *Intercultural Communication in Contexts*; McGraw-Hill Education: New York, NY, USA, 2017

Lee, A.R.; Suzanne Horsley, J. The role of social media on positive youth development: An analysis of 4-H Facebook page and 4-H'ers' positive development. *Child. Youth Serv. Rev.* 2017, 77, 127–138.

Richey, M.; Ravishankar, M.N. The role of frames and cultural toolkits in establishing new connections for social media innovation. *Technol. Soc. Chang.* 2017.

Rosendahl J, Straka GA (2011) Effects of personal, school and company conditions on the professional skills of bank clerks during dual vocational training: Results of a three-year longitudinal study. Research Report Institute for Technology and Education, University of Bremen, Bremen.

Schmitt DP, Long AE, McPhearson A, et al. (2017) Personality and gender differences in global perspective. *International Journal of Psychology* 52(S1): 45-56.

RËNDËSIA E EDUKIMIT PËR MEDIAN NË NXITJEN E ZHVILLIMIT TË TË MENDUARIT KRITIK.

Evjonda Pylli
epylli@unkorce.edu.al

Hyrje

Dekada e fundit ka dëshmuar se zhvillimi i teknologjisë ka arritur nivelin më të lartë që shoqëria njerëzore ka njohur donjëherë. Ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur pothuajse në të gjitha sferat e jetës të shoqërisë njerëzore, anembanë globit. Mundësia për t'u informuar e lundruar në internet nuk është më një risi dhe as pamundësi për çdo kënd që zotëron një "smart-phone", kompjuter apo ndonjë pajisje tjetër elektronike. Ky tashmë është një fakt, dhe shoqëria njerëzore është familjarizuar mjaftueshëm me to.

Tashmë, burimet e informacionit, mënyrat e trasmetimit të tyre, madje dhe mënyrat e interpretimit, kanë ndryshuar. Përballë këtij zhvillimi dinamik shoqëror nevojitet pajisja e njerëzve me një sërë informacionesh se si të mbrohen nga gjithçka që u dëmton atyre jetën, shëndetin a botëkuptimet individuale të tyre . Krijimi i të menduarit kritik do të mundësojë përvetësim të çdo lloj informacioni, përmes fakteve, analizës, sintezës dhe mundësisë të krijimit të qëndrimeve pro dhe kundër fenomeneve të caktuara sociale.

Disa arsye për të besuar dhe disa arsye për të dyshuar, si nxitës të të menduarit kritik.

Krijimi i opinioneve, gjykime a vlerësimeve, është i pashmangshëm në jetën tonë të përditshme. Ne bëhemi vlerësues dhe gjykues të ngjarjeve të caktuara të cilat mund të ndodhin në komuniteti ose më gjerë. Me qëllim që ky vlerësim a gjykim të jetë sa më objektiv, nevojitet ndërhyrja e të menduarit në një mënyrë të ndryshme nga ajo e zakonshme dhe subjektive. Një vlerësim objektiv kërkon një analizim reflektues, objektiv dhe sistematik të informacionit të marë apo situatave të caktuara. Ndërtimi i një mendimi kritik, nuk do të totë të japësh një mendim kritikues ndaj informacionit a një situatë të dhënë, përkundrazi, do të thotë ndërtimi i një mendimi dyshues, zgjerim informacionesh nga burimet të ndryshme, zhvillim emaptie dhe një vetëreflektim të fakteve.

Në përgjithësi, krijimi i të menduarit kritik, kërkon paraprakisht krijimin e disa kushteve thelbësore, pa të cilat ai nuk mund të zhvillohet dhe as të kuptohet. Gjatë vlerësimit që i bëjmë një informacioni çfarëdo, të dëgjuar nga mediat vizive apo audiovizive, etj., ndërhyjnë disa elementë të cilët më shumë sesa e ndihmojnë e pengojnë procesin e vlerësimit objektiv , e mandej, të menduarit kritik si rezultat të tij. Për këtë arsye, mendimi kritik duhet të jetë sa sistematik aq edhe i bazuar në kritere racionale.

Nga ana tjetër, ne na intereson që opinionet e krijuara të jenë sa të vërteta po aq edhe të besueshme , me qëllim që të mund ti përdorim për të na udhëhequr në vendimet që marrim dhe rrugen që ndjekim. Kjo është një tjetër arsye se përse krijimi i të menduarit kritik është me të vërtetë i rëndësishëm. Një nga hapat e parë që duhet ndjekur është përqëndrimi i vëmendjes te “pretendimet”. Në përditshmëri, njerzit përballen me një sërë pretendimesh duke filluar nga ato të pëlqyeshmet por që janë të pambështetura, me shumë imagjinatë dhe tejet të këndshme, e deri te ato të cilat nuk kanë asnjë fakt që e kundërshton por tepër të vështira për t’u pranuar.

Kështu, nëse nuk mund të gjendet një pretendim që rrëzon të parin, atëherë mund të meret e mirëqënë çdo pretendim i mundshëm që dëgjohej ose lexohet. Në fakt jo, nuk është kështu. Në këtë rast, nëse pretendimi në fjalë, bie ndesh me pretendime të tjera, për të cilat nuk ka dyshime dhe ka mjaftueshëm arsye për t’u pranuar, atëherë ka prova për ta vënë atë në dyshim. Pra, pretendimet në këtë rast që

kundërshtojnë njëra tjetrën, mundësojnë të drejtën për të dyshuar dhe kjo është nisja e një procesi sa reflektiv aq edhe të qëndrueshëm, pasi shmang krijimin e një konflikti, (konflikti mund të ndodhë për shkak të sqarimit mes pretendimeve dhe këtu përparësia e njërit apo tjetrit pretendim do të varet vetëm nga provat konkrete).

Gjithashtu, edhe kur një pretendim i caktuar bie ndesh me mendimin e ekspertëve, kjo krijon mundësinë për ta vënë në dyshim . Çështja më e diskutuar këtu lidhet me përcaktimet që njerëz të ndryshëm kanë mbi termin “ekspert”. Me fjalë të tjera, kur një pretendim vihet në dyshim nga ekspertët, atëherë njerëzit kanë prirjen të vazhdojnë në këtë drejtim, pra të kundërshtimit. Edhe në këtë rast, gabimi është i pashmangshëm.

Ndërtimi i një opinion mbi një pretendim si të drejtë ose të gabuar, në një mënyrë arbitrare, të ndikuar nga një ekspert ose disa të tillë, është i gabuar. Eksperti ose ekspertët në këtë rast mund të jenë tërësisht të rremë dhe aspak përgjegjës për pretendimin e dhënë. Në këtë rast ndodh evokimi i autoritetit i cili na justifikon mbi pretendimet tona por nuk na krijon kushtet se po ndërtojmë pretendime të sakta apo të drejta. Kjo ndodh për dy arsye kryesore.

Së pari njerëzit harrojnë se të qënët i kualifikuar dhe me përvojë të mjaftueshme në një fushë të caktuar nuk të bëjnë automatikisht “ekspert” në çdo fushë të jetës njerëzore. Mendimi i tyre si “ekspertë” është i kufizuar vetëm brenda fushës së tyre, (pavarësisht ndërhyrjes së elementëve subjektivë), dhe se opinionet e tyre në fusha të tjera kanë po aq rëndësi sa e njerëzve të cilët nuk e kanë një përvojë të tillë dhe nuk janë ekspertë në ndonjë fushë të caktuar. Natyrisht, që mendimet e ekspertëve mund të jenë të drejta, në asnjë rast nuk mund të paërrjashtohet kjo mundësi, mirëpo ndërtimi i opinionëve tona mbi opinionet e tyre nuk mund të realizohet pasi do të rezultojë jo i saktë. Së dyti, njerëzit vazhdimisht mund të bien pre e trysnisë të autoritetit duke e konsideruar si ekspert, dikë që nuk është i tillë. Rastet më të zakonshme janë kur kompani të ndryshme produktesh a shërbimesh, në reklamat e tyre përfshijnë njerëz të njohur të kinematografisë, sportit, televizionit, politikës etj. Natyrisht që ndërtuesit e reklamave të tilla, janë të vetëdijshëm se aktorët, politikanët, sportistët apo çdo njeri i përfshirë në një reklamë të caktuar, nuk mund të jetë na japë

arsye të mjaftueshme për të na bindur të blejmë produktet ose për të përdorur shërbimet që ofrojnë. Megjithatë, ata shpresojnë se njerëzit do t'i blejnë produktet e do të përdorin shërbimet që ata ofrojnë për shkak të tërheqjes së madhe që njerëzit kanë nga “yjet” që i reklamojnë ato.

Po cilat janë disa nga karakteristikat që duhet të zotërojë dikush me qëllim që të mund të amrë një përcaktim si ekspert?

- Kriteri i parë: Arsimimi dhe trajnimet në insitucionet dhe programet me reputacion në fusha të caktuara, (të vertëtuara me diploma ose çertifikata).

- Kriteri i dytë: Përvoja për të gjykuar në mënyrë të besueshme në fushën e specializimit,

(përgjithësisht sa më shumë vite përvojë, aq më mirë).

Megjithatë, studiues të ndryshëm, sërish nuk mjaftohen me dy kriteret kryesore të mësipërme dhe shtojnë kriteret e tjera si arritjet profesionale dhe reputacioni që njerëzit gëzojnë në radhët e kolegëve të tyre, dhe lidhja direkt me aftësitë intelektuale që priten nga ekspertët e vërtetë .

Marrja parasysh e të gjitha kriterëve më sipër do të mundësojë krijimin e opinioneve gjithnjë e më të sakta, të gjithë pranuar dhe të pakontestueshme, ndoshta për një kohë të gjatë.

Metodat efektive në krijimin e shpjegimeve me bazë argumentin.

Forma më e zakonshme e arsyetimit induktiv është edhe forma më e përdorshme e induksionit. Kjo ndodh sepse njerëzit gjithmonë prirën të gjejnë, të hulumtojnë se cila prej metodave është më e vlefshme, deri sa arrijnë te ajo që quhet “metoda me shpjegimin më të mirë”.

Para se të të japim një përcaktim të kuptimit që ka metoda me shpjegim më të mirë, le të ndalemi te koncepti i shpjegimit, si pjesë e rëndësishme e saj. Shpjegimi nuk është gjë tjetër veçse një pohim ku shpreh se diçka është ose nuk është. Pra, veprimi është i justifikuar duke na njohur me arsyet përse po ndodh ose nuk po ndodh një ngjarje a dukuri. Këtë gjë e mundëson pikërisht shpjegimi, si pikënisja e një procesi përzgjedhës.

Mirëpo, shpjegimi, është i nevojshëm por jo i mjaftueshëm, pasi nuk mund të mbahet një qëndrim mbi këtë pohim nëse do ta pranojmë ose

do ta kundërshtojmë se diçka është realitet. Këtë gjë e mundëson vetëm argumenti. Ky i fundit na lejon të kemi arsye të mjaftueshme për të pranuar diçka ose për ta kundërshtuar atë. Pavarësisht se synimi i shpjegimit dhe argumentit është i përbashkët, kuptimet dhe qëllimet e tyre janë tërësisht të dallueshme nga njëri-tjetri. Madje, shpjegimi mund të jetë pjesë e një argumenti si bërthama e llojit induktiv, të quajtur si “metoda më e mirë”.

Për më tepër, janë premisat ato të cilat krijojnë kushtet për të dalë me një shpjegim rreth një situatë të caktuar a rreth një ngjarje të dëgjuar. Në prani të premisave, ne mund të japim argumente të cilat janë janë logjike, të pranueshme dhe të argumentuara. Në këtë mënyrë dhe shpjegimet që mund të japim në këtë rast, edhe pse personale, janë korrekte.

Po kështu, nisur nga përcaktimi i një shpjegimi të ashtuquajtur “shpjegimi më i mirë”, automatikisht kuptohet dhe pranohet se shpjegimet mund të shfaqen në disa lloje dhe se disa janë më të mira se të tjera, pra kemi një shumëllojshmëri shpjegimesh. Në varësi të përzgjedhjes së llojit të shpjegimit do të përcaktojnë faktin se sa i justifikuar është opinioni i ndërtuar rreth një situatë a dukurie të caktuar.

Këtu na vijnë në ndihmë edhe teori të ndryshme, për të cilat pritshmëritë janë të pranohen apriori. E megjithatë, edhe këto të fundit nuk mund të jenë të gjithëpranuara në mënyrë tërësore pasi edhe vetë shkencëtarët flasin dhe diskutojnë mbi teori të supozuara ose alternative të cilat nuk mund të jenë aq të mira sa të tjerat por mund të jenë të mundshme. Zakonisht në jetën e përditshme, shumë njerëz përpiqen që ngjarje të caktuara, situata të ndryshme etj, t’ua nënshtrorjnë një teorie të caktuar, (asaj që ata njohin ose pranojnë). Madje ata përpiqen që gjithë shpjegimit dhe arsyen e kësaj situatë apo ngjarje t’i nënshtrorhet kësaj teorie. Natyrisht që kjo mund të ndodhë, pasi mundësitë janë që shumë ngjarje të marrin shpjegim prej tyre, mirëpo kjo nuk është e mjaftueshme, pasi përzgjedhja e teorisë mbi bazën e konsistencës së brendshme dhe të jashtme, do ta bëjë lehtësisht të dallueshme nga një tjetër që nuk i plotëson këto dy kritere.

Prandaj është e nevojshme që njerëzit të tregojnë kujdes në mënyrën sesi ndërtojnë gjykimet a vlerësimet e tyre rreth ngjarjeve të

ndryshme të dëgjua, të përjetuara ose të lexuara në media. Rreziku i parë i mundshëm është përballja me ndonjë teori konspirative, e cila nuk është gjë tjetër veçse një grup i strukturuar hipotezash dhe argumentesh, të manipuluar me qëllim që të ushqejnë një narrativë, një ideologji apo një diskutim dhe t'i japin atij një aspekt koherent dhe logjik.

Zakonisht, ndërtimi i tyre bëhet nga një grup i vogël njerëzish por të fuqishëm, që planifikojnë në mënyrë të fshehtë veprime të paligjshme dhe të dëmshme që ndikojnë në rrjedhën e ngjarjeve, me pretendimin se përmes kësaj mënyrë do të mund të arrihet te “e vërteta e madhe”. Pavarësisht karakteristikave më sipër, teoritë konspirative vazhdojnë të mbeten popullore pasi njerëzit priren t'i pranojnë me lehtësi ato, pasi shpjegimi mund të jetë tejet i thjeshtë dhe shpesh herë i kënaqshëm. Teoritë e konspirative mund të shfaqen pas ngjarjeve të rëndësishme për një vend të caktuar ose për gjithë shoqërinë njerëzore, (rasti i ndikimit të vaksinave ndja Covid -19 dhe ndikimit të tyre në shëndetin e njerëzve si teori konspirative të cilat vazhdojnë të jenë mjaft të përhapura edhe në ditët e sotme.

•Kështu, në dhjetor të viti 2020, lajmi kryesor i VOA ishte: cit: **VAKSINIMI KUNDËR COVID-IT NË ANGLI DHE TEORITË KONSPIRATIVE**. “Ekspertët kanë dhënë alarmin lidhur me një pakicë të konsiderueshme njerëzish që besojnë tek teoritë konspirative në lidhje me vaksinën kundër COVID-19-n. Paralajmërimi vjen ndërsa vende të ndryshme po përgatiten të fillojnë vaksinimin në masë të popullsisë për të vendosur pandeminë nën kontroll. Sipas një sondazhi të zhvilluar muajin e kaluar në Britani pothuajse dy të tretat e njerëzve kanë thënë se do të vaksinohen kundër COVID-19. Britania nis programin e saj të vaksinimit këtë javë dhe të tjera vende ka të ngjarë ta ndjekin atë së shpejti, ndaj qeveritë po kërkojnë të garantojnë njerëzit se vaksinat janë të sigurta dhe efikase, në mënyrë që një masë kritike njerëzish ta marrin atë. “Ajo që ne po zbulojmë është se besimi tek teoritë konspirative mund të kenë hyrë në rrjetet kryesore dhe se nuk është më diçka e izoluar. Rreth një e katërta (e popullsisë së Britanisë) po i marrin ato në konsideratë. Një e katërta tjetër mendon vazhdimisht në drejtim të teorisë konspirative, dhe rreth një në 10 vetë duket se i mbështet ato

në një normë shumë të lartë", thotë për agjencinë Reuters, Daniel Freeman, profesor i Psikologjisë Klinike në Universitetin e Oksfordit. (VOA, dhejtor 2020).

Po kështu, për arsytet më sipër, ndikimi teorive konspirative mund të zgjatet në kohë të pacaktuar. Kështu, edhe në Janar të vitit 2024, teoritë konspirative vazhdonin të ishin lajm kryesor i të gjitha mediave të shkruara dhe jo vetëm. Teoria mbizotëruese konspirative ishte: "Vaksinat kundër Covid-19, përmbajnë një lëndë e cila kur injektohet në trup, shndërrohet në një çip magnetik dhe ka për qëllim kontrollin e njerëzve në mbarë botën, nga një grup i vogël individësh të cilët zotërojnë pasuri marramendëse..."

Megjithatë, përballë shumëllojshmërisë së shkrimeve, lajmeve dhe informacioneve që marrim nga burime tashmë të panumërta, njeriu zotëron një "armë të fuqishme" të cilën asnjë mjet i teknologjisë apo teori konspirative nuk ka mundur ta zotërojë: Arsyen njerëzore. Përmes saj, njeriu ka mundësi t'ia nënshtrojë argumentit dhe rrjedhës logjike, çdo informacion të marë, nga cilido qoftë burimi i tij.

Bibliografia

1. Jashari Ali, (2013), Abc-ja për të menduarit kritik: Dija Poradeci, Pogradec.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Fjalor i shqipes së sotme, (2002): Toena Tiranë.
3. Lewis Vaughn & Chris Mac Donald, (2010), Fuqia e të menduarit kritik: Qendra për arsim demokratik, Tiranë 2010.
4. Jeff Zwiers (2005), Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasat 6-12: Qendra për arsim demokratik, (CDE), Simbol Print, Tiranë.
5. Kathleen Mc.Millan & Jonathan Weyers, (2010), Si të shkruajmë ese dhe detyra universitare: Qendra për Arsim Demokratik, (CDE), Tiranë 2010.
6. Matthews, B. & Ross, L. (2010). Metodat e hulumtimit: Qendra për arsim demokratik, (CDE), Tiranë.
7. <https://top-channel.tv/2024/01/31/pse-njerezit-u-besojne-teorive-konspirative/>

RËNDËSIA E MËSIMDHËNIES SË GRAMATIKËS E INTEGRUAR ME BURIME DHE MJETE TË NDRYSHME MEDIATIKE

Suela Koça
spici@unkorce.edu.al

Hyrje

Në epokën moderne të informacionit dhe teknologjisë, integrimi i burimeve dhe mjeteve mediatike në mësimdhënien e gjuhës angleze, veçanërisht gramatikës, po bëhet një praktikë gjithnjë e më e përhapur edhe në vendin tonë. Përdorimi i teknologjisë jo vetëm që përmirëson përvojën mësimore, por gjithashtu ndihmon në ruajtjen e interesit dhe motivimit të nxënësve. Mënyrat tradicionale të mësimdhënies, të cilat përqendroheshin kryesisht në libra dhe tabelë, po transformohen me përfshirjen e videove, platformave online, rrjeteve sociale dhe burimeve të tjera multimediale. Kjo qasje e integruar i bën leksionet më interaktive dhe i ndihmon nxënësit të përvetësojnë më mirë rregullat gramatikore, sepse edhe interesi i tyre rritet dukshëm.

I. Rëndësia e integrimit të medias në mësimdhënien e gramatikës
Shumë studime kanë treguar se përdorimi i mediave të ndryshme në mësimdhënie ndihmon në zhvillimin e aftësive gjuhësore, veçanërisht kur bëhet fjalë për gramatikën. Burimet mediatike jo vetëm që e bëjnë mësimin më të këndshëm, por gjithashtu stimulojnë më mirë mendimin kritik dhe krijojnë lidhje të reja mes përmbajtjes teorike dhe situatave reale. Këtu janë disa përparësi të përdorimit të mjeteve mediatike në mësimdhënien e gramatikës:

1. Përshtatja me stile të ndryshme të të nxënësve: Nxënësit kanë stile të ndryshme të të nxënësve: vizual, dëgjimor, kinestetik, etj. Mjetet mediatike mundësojnë një qasje të integruar që i përfshin këto stile, duke përdorur video, imazhe, tekste dhe audio. Për shembull, një video mund të ndihmojë nxënësit të shohin përdorimin praktik të kohëve të ndryshme gramatikore, ndërsa një platformë si Quizlet mund të përdoret për të përforcuar njohuritë përmes lojërave interaktive.

2. Zgjerimi i aksesit në burime reale: Burimet online, siç janë artikujt nga gazetatat, blogjet, podcast-et dhe videot nga YouTube, ofrojnë shembuj të gramatikës në përdorimin e përditshëm. Nxënësit mund të analizojnë fjali nga këto burime për të kuptuar më mirë si përdoret gramatika në situata të ndryshme komunikimi.

3. Angazhimi dhe motivimi më i madh i nxënësve: Mjetet mediatike, si lojërat mësimore dhe aplikacionet për telefonat inteligjentë, krijojnë një atmosferë më dinamike në klasë, duke e bërë mësimin më tërheqës. Përdorimi i platformave sociale si Facebook ose Instagram për të krijuar ushtrime gramatikore apo për të ndarë shembuj të përdorimit të saktë të gramatikës është një metodë inovative për të rritur motivimin.

II. Mjetet dhe burimet mediatike në mësimdhënien e gramatikës

Përdorimi i mediave për të mësuar gramatikën mund të ndahet në disa kategori, në varësi të burimeve të përdorura:

1. Video dhe platforma streaming

Platformat si YouTube dhe Vimeo ofrojnë një gamë të gjerë videosh edukative që trajtojnë tema të ndryshme gramatikore. Për shembull, mësuesit mund të përdorin video që shpjegojnë rregullat gramatikore dhe pastaj të organizojnë diskutime ose ushtrime bazuar në përmbajtjen e videos. Videot gjithashtu ndihmojnë në kontekstualizimin e gramatikës në situata reale, si biseda të përditshme apo intervista.

2. Rrjetet sociale

Rrjetet sociale mund të përdoren si mjete për të ndihmuar nxënësit të praktikojnë gramatikën në mënyrë interaktive. Për shembull, mësuesit mund të krijojnë grupe në Facebook për të shpërndarë shembuj të gramatikës dhe për të ndihmuar nxënësit të diskutojnë rregullat gramatikore në një kontekst praktik. Instagrami mund të përdoret për të shpërndarë postime me përshkrime që shërbejnë si ushtrime për identifikimin e gabimeve gramatikore.

3. Podcast-et dhe audioburimet

Podcast-et që trajtojnë tema edukative, veçanërisht ato që lidhen me gramatikën dhe gjuhën, janë një mënyrë efikase për të përmirësuar aftësitë dëgjimore dhe gramatikën. Nxënësit mund të dëgjojnë këto

burime gjatë udhëtimeve ose aktiviteteve të përditshme dhe të shënojnë shembuj të strukturave gramatikore për t'i diskutuar në klasë.

4. Aplikacionet mësimore

Aplikacione të tilla si Duolingo, Grammarly dhe Kahoot janë shumë të dobishme për përforsimin e njohurive gramatikore. Këto aplikacione ofrojnë një sërë ushtrimesh dhe testesh që i ndihmojnë nxënësit të praktikojnë dhe përmirësojnë gramatikën në një mënyrë interaktive dhe argëtuese. Për shembull, Duolingo përdor algoritme për të përshtatur ushtrimet gramatikore me nivelin e përparimit të nxënësit, duke i ofruar atij sfida që i ndihmojnë të avancojë.

5. Platformat e mësimin online

Platformat si Google Classroom, Moodle dhe Edmodo mundësojnë ndarjen e materialeve gramatikore në mënyrë të strukturuar dhe të qasshme për nxënësit. Këto platforma ofrojnë gjithashtu mundësinë për të organizuar teste online dhe për të monitoruar përparimin e nxënësve në mësimin e gramatikës.

III. Shembuj praktikë të integrit të mediave në orë mësimore të gramatikës

Një shembull konkret i integrit të mediave në mësimdhënien e gramatikës mund të jetë përdorimi i një filmi të shkurtër për të analizuar fjalitë e përdorura në dialogët e personazheve. Nxënësit mund të identifikojnë llojet e fjalive (deklarative, pyetëse, urdhërore, etj.) dhe të analizojnë si ndikon përdorimi i këtyre strukturave në tonin dhe mesazhin e filmit.

Një tjetër shembull është krijimi i një faqeje në rrjetet sociale, ku mësuesi poston rregullisht fjali të gabuara gramatikisht, dhe nxënësit duhet të diskutojnë dhe të korrigjojnë gabimet. Kjo metodë krijon ndërveprim dhe përfshirje, ndërsa forcon konceptet gramatikore.

Disa shembuj të studimeve në këtë fushë mund të përfshijnë:

1. Richards, J. C., & Renandya, W. A. (Eds.). (2002). *Methodology in Language Teaching: An Anthology of Current Practice*. Cambridge University Press. Ky libër përmban një koleksion artikujsh që trajtojnë qasjet dhe metodat moderne në mësimdhënien e gjuhëve, përfshirë përdorimin e teknologjisë në klasë.

2. Chapelle, C. A. (2003). *English Language Learning and Technology: Lectures on Applied Linguistics in the Age of Information and Communication Technology*. John Benjamins Publishing. Kjo vepër fokusohet në përdorimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze dhe në përfitimet që kjo ofron për të gjitha aspektet e gjuhës, përfshirë gramatikën.
3. Beatty, K. (2010). *Teaching and Researching Computer-Assisted Language Learning*. Routledge. Ky është një studim i plotë mbi mësimin e gjuhës së ndihmuar nga teknologjia dhe përfitimet e mediave të reja në klasë.
4. Warschauer, M., & Healey, D. (1998). Computers and language learning: An overview. *Language Teaching*, 31(2), 57-71. Ky është një studim edhe me i hershëm që trajton integrimin e kompjuterëve dhe teknologjisë në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, duke përfshirë edhe gramatikën.
5. Godwin-Jones, R. (2015). Emerging technologies: The evolving roles of social media in language learning. *Language Learning & Technology*, 19(1), 10-19. Ky artikull analizon përdorimin e rrjeteve sociale dhe mediave të reja në zhvillimin e aftësive gjuhësore, me përqendrim në ndërveprimin dhe mësimin e gramatikës përmes këtyre mjeteve.

Përfundime

Integrimi i burimeve dhe mjeteve mediatike në mësimdhënien e gramatikës së gjuhës angleze e bën procesin e mëimit më gjithëpërfshirës, më interaktiv dhe më të përshtatur me nevojat e nxënësve të sotëm. Me shumëllojshmërinë e burimeve të disponueshme, mësuesit kanë mundësinë të krijojnë një ambient të pasur mësimesor që e bën gramatikën më të kapshme dhe të këndshme. Teknologjia dhe media jo vetëm që ndihmojnë në thjeshtimin e konceptimit të rregullave gramatikore, por gjithashtu përforcojnë aftësitë praktike të komunikimit dhe të përdorimit të gjuhës në situata reale.

Në përfundim, mund të themi se është mjaft e rëndësishme që mësuesit e ardhshëm të gjuhës angleze duhet të përgatiten për t'u përballur me sfidat që ofron kjo qasje ndaj mësimdhënies së

gramatikës. Me synimin për t'i thelluar këto njohuri në vazhdim, si hap të parë propozojmë përfshirjen e temave të mëposhtme në syllabusin e lëndës “Metodat e mësimdhënies së gramatikës së gjuhës angleze”:

- Nxjerrja në pah e dallimeve midis llojeve të ndryshme të gramatikës duke parë filmin “Pygmalion”
- Facebook si një mjet për mësimin e gramatikës
- Të mësuarit e llojeve të ndryshme të fjalive nëpërmjet shembujve nga përrallat.

INTEGRIMI I EDUKIMIT PËR MEDIAN NË KOMUNIKIMIN NDËRKULTUROR NË MËSIMDHËNIE

Edlira Xega

exega@unkorce.edu.al

Hyrje

Në një botë ku kufijtë kulturore bëhen gjithnjë e më të paqarta dhe ndërveprimet ndërkulturore janë të përditshme, zhvillimi i aftësive të komunikimit ndërkulturore ka fituar një rëndësi të veçantë. Për individët në përgjithësi dhe studentët në veçanti, është tepër e rëndësishme të kuptojnë ndikimin e kulturës në proceset e komunikimit dhe të zhvillojnë strategji për të përmirësuar ndërveprimet ndërkulturore. Duke kombinuar teori dhe praktika, synohet të ndërtohet një kuptim i thellë i kompleksitetit të komunikimit ndërkulturore dhe i përgatitjes së individëve për të përballuar sfidat dhe mundësitë që vijnë nga një botë gjithnjë e më shumëkulturore.

Në një botë të ndërlidhur globalisht, ku mediat luajnë një rol kyç në formimin e perceptimeve dhe qëndrimeve, lidhja midis komunikimit ndërkulturore dhe edukimit për mediat bëhet e domosdoshme. Komunikimi ndërkulturore, i cili përqendrohet në ndërveprimet mes njerëzve nga kultura të ndryshme, dhe edukimi për mediat, që synon të pajisë individët me aftësitë për të analizuar dhe kuptuar mesazhet mediatike, janë dy fusha që ndërthuren në mënyrë të pandashme në kontekstin e edukimit modern.

Integrimi i medias në lëndën e Komunikimit Ndërkulturore jo vetëm që pasuron përvojën mësimore, por gjithashtu përgatit studentët për të qenë qytetarë të angazhuar dhe komunikues të suksesshëm në një botë gjithnjë e më të ndërvarur dhe të diversifikuar kulturore. Media shërben si një ndërmjetës i fuqishëm për të sjellë kultura të ndryshme pranë njëra-tjetrës, si edhe ndihmon studentët të kuptojnë dhe të njohin më mirë traditat, vlerat, dhe mënyrat e jetesës të kulturave të tjera, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive për të komunikuar me njerëz nga kontekste të ndryshme kulturore. Nisur nga kjo, studentët bëhen më të hapur dhe më të ndërgjegjshëm për diversitetin kulturor,

gjë që është thelbësore në një botë të globalizuar. Për më tepër, në një epokë ku informacioni dhe komunikimi kalojnë kryesisht nëpërmjet medias, është thelbësore që studentët të zhvillojnë aftësitë për të analizuar, kuptuar, dhe përdorur median në mënyrë kritike, duke mësuar të interpretojnë mesazhe mediatike nga perspektiva të ndryshme kulturore dhe të shmangin keqkuptimet që mund të lindin nga interpretimet e ndryshme. Filmata, dokumentarët, dhe lajmet ndërkombëtare mund të shërbejnë si baza për diskutime rreth konflikteve kulturore, emigracionit, dhe çështjeve të tjera globale, informacione të cilat i nxitin studentët që përmes reflektimit dhe diskutimit të çështjeve që prezantohen në media, të zhvillojnë aftësitë kritike dhe ndjeshmërinë ndaj pikëpamjeve dhe përvojave të të tjerëve.

Në një botë që po ndryshon vazhdimisht për shkak të teknologjisë dhe medias, është e rëndësishme që studentët të mësojnë të jenë fleksibël dhe të adaptueshëm ndaj këtyre ndryshimeve. Integrimi i medias në mësimdhënie u jep atyre mundësinë të kuptojnë dhe të përballen me dinamizmin e komunikimit global. Studentët mësojnë të përdorin teknologjinë dhe median në mënyrë efektive për të mbajtur ritmin me ndryshimet në komunikimin ndërkulturor.

II. Një vështrim mbi tematikat e integritimit EMI në lëndën e Komunikimit Ndërkulturor në Universitet.

Në lëndën e Komunikimit Ndërkulturor në mësimdhënie, në disa tema kemi synuar të përfshijmë edhe integrimin e EMI. Komunikimi Ndërkulturor ndërton tek studentët një aftësi kritike për të analizuar përmbajtjen mediatike përmes një lenteje ndërkulturore, duke i ndihmuar ata të bëhen jo vetëm konsumatorë të vetëdijshëm të mediave, por edhe ndërmjetës të aftë në komunikimin ndërkulturor. Përmes kësaj qasjeje, studentët do të mësojnë të njohin dhe sfidojnë stereotipet dhe paragjykimet në media, duke zhvilluar aftësitë e nevojshme për të promovuar një komunikim më të drejtë dhe më gjithëpërfshirës në një shoqëri të larmishme.

Një nga temat e trajtuara ka të bëjë me Impaktin e stereotipeve në reklamat mediatike, temë gjatë së cilës studentët zhvilluan aftësi për të analizuar në mënyrë kritike reklamat/publicitetet në media/televizion duke identifikuar, analizuar dhe vlerësuar impaktin e tyre

në jetën e individëve. Për më tepër ata kuptuan ndikimin shoqëror të stereotipeve në media, duke përfshirë mënyrën se si ato formësojnë perceptimet publike, përforcojnë paragjykimet dhe ndikojnë në sjelljes. Gjatë zhvillimit të kësaj teme, studentët fituan aftësi në punën kërkimore mbi efektet e stereotipeve në reklamën mediatiqe, duke përdorur metoda cilësore dhe sasore. Reklamën janë një pjesë integrale e përditshmërisë sonë. Shfaqur në media, ato ndikojnë në mendimet, dëshirat tona dhe në formimin e perceptimeve tona për veten dhe të tjerët. Megjithatë, nën fasadën me shkëlqim të këtyre reklamave fshihet një çështje më komplekse: stereotipet. Këto portretizime kanë përjetësuar disa pritshmëri në aspekte të ndryshme të jetës, duke kufizuar individualitetin dhe duke përforcuar normat e dëmshme.

Në veprimtarinë praktike gjatë seminareve, studentët u angazhuan në një veprimtari disa ditore mbi dokumentimin e reklamave që shfaqen në televizionet shqiptare. Ata studiuuan numrin e përfaqësuesve të grupeve të ndryshme etnike, racore, gjinore, si dhe të produkteve që shfaqen në reklama dhe rolin që luan çdo person. Bazuar në punën e tyre kërkimore, studentët raportuan të dhëna duke bërë një klasifikim dhe një analizë të stereotipeve kulturore që shfaqen në reklama. Më poshtë janë përmendur disa shembuj specifikë sjellë nga studentët. Secili koncept i trajtuar është ilustruar me sitin përkatës të reklamës. Rezultatet e studentëve konfirmuan që përgjithësisht reklamën televizive bëjnë specifikime të pabarazisë gjinore, gjë kjo e cila shfaqet dukshëm tek gratë, të cilat shihen si pronë e produkteve ushqimore, gatimit

<https://www.youtube.com/watch?v=npJXDHPfB2Q>

apo detergjentëve <https://www.youtube.com/watch?v=ahsAI-TTEVs>. Është ky një stereotip i qëndrueshëm që nënat kanë përgjegjësi për shtëpinë.

Në reklamën televizive, gratë shihen gjithashtu si objekte seksuale për të tërhequr vëmendjen në reklamimin e produktit, duke u zveshur kështu nga vlerat njerëzore.

(<https://www.youtube.com/watch?v=t4TO-Brya8Q>).

Pijet alkolike dhe energjike shoqërohen shpesh me imazhin e burrave, një stereotip që ka ekzistuar prej kohësh, duke theksuar fuqi fizike dhe dominancë.

(<https://www.youtube.com/watch?v=NNUzaiA0tnk>)

Shumë reklama i portretizojnë gratë si qenie të pafuqishme që kanë nevojë për ndihmë. Ky portretizim nxit një dinamikë jo të shëndetshme të pushtetit midis gjinive. Gratë janë individë plotësisht të afta që mund të kapërcejnë sfida pa u mbështetur tek një shpëtimtar. Ose qoftë reklamimimi i standarteve jorealiste të bukurisë; femrat me lëkurë perfekte dhe tipare delicate

(<https://www.youtube.com/watch?v=MN4hqK1ctDE>) dhe meshkujt me një trup të palestruar. Këto çojnë në vlerësim të ulët të vetes duke ndikuar direkt tek personaliteti i individit.

Reklammat rrallë shfaqin gra ose burra të moshuar. Kjo përforcon nocionin se vetëm rinia është e vlefshme dhe e dëshirueshme, duke lënë pas dore bukurinë dhe mençurinë që vjen me moshën. (<https://www.youtube.com/watch?v=AWp4f5Wrrh0>)

Ngjyra e kuqe portretizon figurën femërore, dhe në reklama protagoniste janë gra, ngjyrat e errëta shihen tek burrat

(<https://www.youtube.com/watch?v=t4TO-Brya8Q>)

Të gjitha këto stereotipe kanë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe thelbësor në të menduarin dhe të perceptuarin në qëndrimet, sjelljet dhe reagimet e individëve. Sugjerimet e studentëve dhe rezultatet e analizës së tyre, treguan fuqinë e medias dhe efektin e saj në formimin e identitetit, sjelljen e individëve dhe komunikimit ndërkulturor.

Tema tjetër e trajtuar në orët e seminareve, trajtoi rolin e mediave sociale në integrimin kulturor. Në këtë temë studentët kuptuan sesi prezenca e mediave sociale, sjell sfida të reja në shoqëri dhe në edukimin ndërkulturor. Studentët zhvilluan aftësinë për të analizuar në mënyrë kritike përmbajtjen dhe ndërveprimet e mediave sociale, duke identifikuar se si këto platforma ndikojnë në integrimin kulturor, si edhe ofruan strategji për të adresuar sfidat që lidhen me integrimin kulturor në mediat sociale, të tilla si luftimi i keqinformimit ose reduktimi i keqkuptimeve kulturore. Platformat e mediave sociale lejojnë njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore të ndërveprojnë dhe të ndajnë përvojat, perspektivat dhe traditat e tyre. Ky ndërveprim

nxit mirëkuptimin dhe respektin reciprok, të cilat janë thelbësore për integrimin kulturor. Rrjedhimisht, studentët bëhen më të hapur dhe më të vetëdijshëm për diversitetin kulturor, i cili është thelbësor në një botë të globalizuar. Në epokën në të cilën jetojmë, ku informacioni dhe komunikimi bëhet kryesisht përmes medias, studentët duhet të zhvillojnë aftësitë për të analizuar, kuptuar dhe përdorur median në mënyrë kritike. Këto aftësi janë të rëndësishme për të komunikuar në mënyrë efektive në kontekste ndërkulturore.

Në trajtimin, përvetësimin dhe diskutimin e kësaj teme studentëve ju kërkuan dy veprimtari:

E para rezultonte në punë kërkimore dhe prezantim. Ata hulumtuan shembuj specifikë se si mediat sociale lehtësojnë integrimin kulturor, duke zgjedhur tema si muzika, moda, gjuha, ushqimi dhe prezantuan kërkimin e tyre, duke përfshirë shembuj dhe një diskutim mbi ndikimin e medias në integrimin kulturor. Kjo veprimtari pati si qëllim zhvillimin e aftësive kërkimore, të menduarin kritik dhe aftësi të qarta në prezantimin e informacionit. Shembujt e sjellë nga studentët rezultuan në:

- Mënyrën se si Instagram dhe TikTok kanë popullarizuar shkëmbimet e kulturës ushqimore, ku njerëz nga pjesë të ndryshme të botës ndajnë recetat e tyre tradicionale dhe praktikat e kuzhinës. Për shembull, popullariteti viral i pjatave si sushi japonez, kerri indian ose tako meksikane në mediat sociale ka çuar në adoptimin dhe përshtatjen e tyre të gjerë në vende të ndryshme. Ky shkëmbim jo vetëm që i prezanton njerëzit me kuzhinat e reja, por gjithashtu integron aspekte të këtyre kulturave në jetën e përditshme.

- “Hashtags” kanë luajtur një rol vendimtar në rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet kulturore dhe sociale. Këto lëvizje, të cilat filluan në Shtetet e Bashkuara, fituan vëmendjen ndërkombëtare përmes mediave sociale, duke çuar në biseda globale rreth racës, gjinisë dhe drejtësisë. Njerëz nga kultura të ndryshme kontribuan në këto diskutime, duke ndarë përvojat e tyre dhe duke i integruar këto lëvizje globale në kontekstet e tyre kulturore lokale. Disa nga shembujt që studentët sollën në lidhje me përdorimin e hashtags në kontekstin shqiptar janë: #albania: 34.06 %, #tirana: 10.74 %, #travel: 7.63 %, #love: 5.64 %, #nature: 5.39 %, #visitalbania: 4.68 %, #

#photography: 4.56 %, #photooftheday: 4.42 %, #summer: 4.26 %, #instagood: 4.06 %, #beautiful: 3.59 %, #sea: 3.15 %, #beach: 3.11 %, #shqiperia: 2.78 %, #saranda: 2.55 %, #travelphotography: 2.40 %, #sunset: 2.35 %, #holiday: 2.32 %, #picoftheday: 2.28 %, #instatravel: 2.10 % etj

- Mediat sociale kanë mundësuar festimin global të ngjarjeve kulturore si Viti i Ri Kinez, Ramazani, etj. Ose edhe të kulturave rajonale, konkretisht atë të Korçës, si Festa e Birres, Festa e Lakrorit, Karnavalet. Njerëz nga vende të ndryshme e me kombësi të ndryshme, marrin pjesë në këto festime duke ndarë kulturat e tyre, duke mësuar për rëndësinë e ngjarjeve dhe madje duke adoptuar disa zakone e tradita. Këto festime virtuale ndihmojnë në integrimin e praktikave të ndryshme kulturore në strukturën sociale globale.

Promovimi i kulturës tradicionale shqiptare, bëhet përmes mediave dhe rrjeteve sociale, influencerat shqiptarë përdorin platformat si Instagram, YouTube dhe Facebook për të shfaqur muzikën, vallëzimin, kuzhinën dhe zakonet tradicionale shqiptare. Për shembull, këngët popullore shqiptare, veshjet tradicionale si "xhubleta" dhe vallet shfaqen shpesh në postimet e mediave sociale, duke ndihmuar në ruajtjen dhe promovimin e këtyre aspekteve të kulturës shqiptare si brenda vendit ashtu edhe në diasporë. Kjo ka çuar gjithashtu në rritjen e interesit për këto tradita tek brezat e rinj, të cilët influencohen së tepërmi më shumë nga tendencat/trendet globale. Ky promovim forcon identitetin kombëtar duke integruar edhe elementë të kulturës shqiptare në hapësirën dixhitale globale, ku mund të vlerësohet nga një audiencë më e gjerë.

- Promovimi i turizmit kulturor. Fushatat e mediave sociale si nga qeveria ashtu edhe nga subjektet private kanë qenë të rëndësishme në promovimin e Shqipërisë si një destinacion turistik kulturor. Instagram dhe YouTube janë të mbushura me përmbajtje që shfaqin bukuritë natyrore, vendet historike dhe trashëgiminë kulturore të Shqipërisë, si qytetet e Beratit dhe Gjirokastrës, të cilat janë vende të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Kjo ka tërhequr turistë me prejardhje të ndryshme kulturore, të cilët vizitojnë Shqipërinë dhe ndajnë përvojat e tyre në mediat sociale, duke nxitur më tej shkëmbimin kulturor.

Si rrjedhim kjo rritje e turizmit kulturor nxit një kuptim dhe vlerësim më të madh të kulturës shqiptare midis vizitorëve ndërkombëtarë dhe ndihmon në integrimin e Shqipërisë në botën globale.

Tema e influences së medias në integrimin kulturor, përforcohet me veprimtari tjetër praktike në orën tjetër të seminarit, e cila konsiston në debat me temën: “Mediat sociale promovojnë integrimin kulturor më shumë sesa shkaktojnë homogjenizimin kulturor”. Klasa ndahet në dy grupe, ku njëri grup argumenton në favor të mediave sociale si një mjet për integrimin kulturor dhe tjetri argumenton se kjo çon në homogjenizim kulturor. Secili grup siguron prova dhe shembuj për të mbështetur qëndrimin e tij.

Qëllimi i kësaj veprimtarie është zhvillimi i aftësive argumentuese tek studentët, puna në grup dhe aftësia për të vlerësuar këndvështrime të ndryshme si edhe shërben si një mënyrë efektive për të nxitur mendimin kritik dhe diskutimin mes studentëve.

Në këtë mënyrë studentëve u jepet mundësia për të diskutuar në mënyrë të thellë mbi ndikimin e rrjeteve sociale në integrimin dhe homogjenizimin kulturor. Të njohur me strukturën dhe hapat e debatit, ata paraqesin pikat kryesore të argumenteve me mbledhjen e provave, statistikave, studimeve dhe shembujve për të mbështetur argumentet e tyre. Në fund studentët vlerësohen për forcën e argumentave, paraqitjen e evidencave, qartësinë e të folurit, punën në grup dhe aftësinë për t’u angazhuar me palën kundërshtuese.

Një temë tjetër e përzgjedhur, tek e cila komunikimi ndërkulturor integrohet me median, është- Filmi dhe televizioni si tekste kulturorë. Kjo temë i ndihmoi studentët të kuptojnë se si filmat dhe programet televizive pasqyrojnë dhe formësojnë vlerat, normat dhe ideologjitë kulturore nëpër shoqëri të ndryshme. Ata do të zhvillojnë aftësinë për të analizuar në mënyrë kritike filmat dhe shfaqjet televizive si tekste kulturore, duke identifikuar temat kryesore, simbolet dhe narrativat që përcjellin kuptime kulturore.

Ndikimi i filmave në kulturë mund të jetë mjaft i dobishëm për studentët në pasurimin e edukimit dhe zhvillimin e tyre personal; filmat shpesh përshkruajnë tradita të ndryshme kulturore, vlera dhe norma shoqërore, duke i lejuar studentët të fitojnë njohuri rreth kulturave të ndryshme nga ato të tyre. Ky ekspozim ndihmon në

nxitjen e ndjeshmërisë kulturore dhe një kuptimi më të gjerë botëror të kontekstit kulturor të periudhave të ndryshme.

Studentëve ju caktohet detyrë të analizojnë filmat ose shfaqje televizive si tekste kulturore që pasqyrojnë dhe formësojnë komunikimin ndërkulturor. Ata diskutojnë se si portretizohen kultura të ndryshme në kinemanë ndërkombëtare dhe se si këto portretizime ndikojnë në mirëkuptimin ndërkulturor.

Studentët krahasojnë dhe bëjnë kontrastin e filmave nga kultura të ndryshme që kanë të bëjnë me tema të ngjashme (p.sh. migrimi, familja, identiteti etj) dhe diskutojnë se si konteksti kulturor ndikon në zhvillimin e rrëfimit dhe karakterit.

Studentët ndahen në dy grupe në varësi të filmave që ata përzgjedhin. Secili grup dorëzon një esse pas shikimit dhe analizës së filmave që i përkasin dy kulturave të ndryshme. Filmat u përzgjedhën nga vetë studentët; "Parasite" (2019, South Korea, directed by Bong Joon-ho) dhe "The Godfather" (1972, United States, directed by Francis Ford Coppola).

Grupi tjetër i studentëve reflektuan dhe krahasuan filmat "Crouching Tiger, Hidden Dragon" (2000, China, directed by Ang Lee) dhe "Pride and Prejudice" (2005, United Kingdom, directed by Joe Wright).

Përmes esseve dhe aftësive të shkruarit, studentët identifikun dhe analizuan se si kulturat e ndryshme përfaqësohen në filmat e krahasuar, duke u fokusuar në mënyrën se si media reflekton dhe formëson këto përfaqësime. Ata vlerësuan elementët unikë të secilës kulturë dhe kuptuan se si këto elementë kontribuojnë në diversitetin kulturor global. Ata eksploruan se si globalizimi ndikon në përmbajtjen dhe shpërndarjen e filmave, duke analizuar mënyrën se si elementët kulturorë integrohen ose uniformizohen për një audiencë globale. Nëpërmjet krahasimit të dy filmave, studentët mund të zhvillojnë një perspektivë kritike mbi mënyrën se si media ndikon në kulturë, duke vlerësuar përfitimet dhe rreziqet e këtij ndikimi. Ata analizuan mesazhet ideologjike që filmat transmetojnë dhe kuptuan rolin e mediave në formimin e ideologjive kulturore dhe sociale, si dhe ndikimin që filmat kanë në shoqëri, duke përfshirë mënyrën se si ndikojnë në normat dhe vlerat kulturore.

Përmes krahasimit të filmave, studentët përmirësojnë aftësitë e tyre të kërkimit, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, analizën kritike dhe shkrimin akademik, si dhe paraqitjen mendimet e tyre në mënyrë të qartë dhe koherente. Këto rezultate ndihmojnë studentët të zhvillojnë një kuptim më të thellë të rolit të mediave në kulturë dhe të fitojnë aftësi që janë të vlefshme për studime të mëtejshme dhe për karrierat e tyre të ardhshme.

Përfundime

Në përfundim, integrimi i medias në kulturë luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si individët dhe shoqëritë formojnë dhe përjetojnë identitetet kulturore. Media, përmes filmave, televizionit, rrjeteve sociale dhe formave të tjera të komunikimit, jo vetëm që reflekton, por edhe ndikon në normat, vlerat dhe perceptimet kulturore. Përmes shpërndarjes së gjerë të përmbajtjes, media ka fuqinë të promovojë diversitetin kulturor dhe të ndihmojë në procesin e integritit kulturor, duke krijuar ura lidhëse mes kulturave të ndryshme.

Megjithatë, është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për sfidat që vijnë me këtë ndikim, si përhapja e stereotipeve dhe uniformizimi kulturor, që mund të çojnë në homogjenizim të kulturave lokale. Në këtë kontekst, është thelbësore të promovojmë një përdorim të përgjegjshëm të medias që inkurajon respektin për diversitetin dhe që reflekton në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të gjitha kulturat.

Integrimi i medias në kulturë duhet të konsiderohet si një proces dinamik që ofron mundësi të mëdha për ndërtimin e një shoqërie më të ndërgjegjshme dhe të integruar, por që kërkon gjithashtu kujdes dhe përgjegjësi nga të gjithë aktorët e përfshirë.

Referenca

Butarbutar, R., Weda, S., Nur, S., Radja, L (2023). Integrating Intercultural Communication on SocialMedia and Learning Materials encourages Speaking EFL Motivation. Conference of Education

Research International (OCERI 2023) (pp.518-529),
DOI:10.2991/978-2-38476-108-1_50

Breaking the Mold: 10 Common Gender Stereotypes in Advertising and Why It's Time for Change, (July 22, 2023).

Çela, E., Myzeqari, I., Sotirofski, K., Zguri, Rr. (2023) Udhëzues për përfshirjen e edukimit për median dhe informacionin në Kurrikulën universitare.Qasja e të mësuarit përmes lëndës specifike dhe integritimit ndërlëndor. Instituti Shqiptar i Medias
<https://www.institutemedia.org/category/publications/>

Hendrickson, B. and Rosen, D. (2017). Insights into New Media Use by International Students: Implications for Cross-Cultural Adaptation Theory. *Social Networking*, 6, 81-106. Doi: 10.4236/sn.2017.62006.

Lynn, H., (2023). The Impact of Film on Culture: Reflections on Movie Industry, Violent Impact and Politicized Content Production. *Proceedings of the International Conference on Global Politics and Socio-Humanities* DOI: 10.54254/2753-7064/13/20230366

Martin, J. N., Nakayama, Th. K., (2010). *Intercultural communication in contexts*. Fifth edition, New York.

Wibowo, G. A., (2023). The Influence of Social-Media on Cultural Integration: A Perspective on Digital Sociology. *International Journal of Science and Society* 5(4):363-375(4):363-375. DOI:10.54783/ijsoc.v5i4.792

Understanding Media and Culture: An Introduction to Mass Communication. (2016). University of Minnesota.